



Bruksel, 8.11.2023
KOM(2023) 692 final

2023/0397 (DOK)

Propozim për

RREGULLORE TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT

**për krijimin e Mekanizmit për Reformë dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin
Perëndimor**

MEMORANDUM SHPJEGUES

1. KONTEKST I PROPOZIMIT

• Arsyet dhe objektivat e propozimit

Konvergenca e pamjaftueshme socio-ekonomike midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së ka qenë një çështje e gjatë, e përkeqësuar nga ndikimi ekonomik i luftës së paprovokuar dhe të pajustificuar të agresionit rus kundër Ukrainës dhe më parë nga pandemia COVID-19. Niveli i konvergjencës ekonomike të Ballkanit Perëndimor në termat e BPV-së për kokë banori në standardet e fuqisë blerëse është midis 30% dhe 50% të mesatares së BE-së dhe nuk po përparon mjaftueshëm shpejt. Është thelbësore për Ballkanin Perëndimor, për Bashkimin Evropian dhe për procesin e anëtarësimit që kjo shkallë konvergjence të përshejtohet. Një nivel më i lartë i konvergjencës do të lehtësojë shumë integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE.

Konvergenca ekonomike është në qendër të përfitimeve të anëtarësimit në BE: përvoja e raundit të pestë të zgjerimit të BE-së, ku disa nga shtetet më të reja anëtare kanë arritur nivele të të ardhurave në 90% ose më shumë të mesatares së BE-së, tregon ndikimin që ka integrimi ekonomik dhe hapja e tregut që lind nga anëtarësimi në Tregun e Vetëm të kombinuar me Politikën e Kohezionit ka në konvergjencën ekonomike. Duke pasur parasysh specifikat e rajonit, integrimi progresiv me Tregun e Përbashkët edhe para anëtarësimit mund të jetë në gjendje të zhblllojë disa nga përfitimet më herët. Një integrim i tillë progresiv duhet të përgatitet me kujdes dhe duhet të paraprihet nga bashkëpunimi dhe integrimi i ngushtë rajonal si masë përgatitore.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka zhvilluar **Planin e Rritjes** për Ballkanin Perëndimor (të paraqitur në detaje në një komunikatë paralele të Komisionit). Ai bazohet në katër shtylla:

- Rritja e integritimit ekonomik me Bashkimin Evropian;
- Integrimi ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor: Tregu i Përbashkët Rajonal;
- Reformat themelore;
- Rritja e ndihmës financiare.

Ky mekanizëm do të shërbejë si pjesa kryesore e Planit të Rritjes Ekonomike, duke rritur ndjeshëm ndihmën financiare bazuar në një agjendë reformash ambicioze që fokusohet në reformat e nevojshme socio-ekonomike të shoqëruara me reforma themelore, duke përfshirë sundimin e ligjit dhe investimet e synuara. Kjo do të vendosë kushtëzim të fortë duke krijuar një mekanizëm pagese bazuar në arritjet e këtyre reformave. Një qasje e tillë kërkon një dizajn krejtësisht të ri, të ndryshëm nga instrumentet e disponueshme aktualisht të ndihmës së jashtme.

Ndihma aktuale financiare për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në kuadër të Instrumentit të Para-Aderimit (IPA III), do të vazhdojë në formën e saj aktuale dhe do të synojë përafrimin në rritje të legjislacionit kombëtar dhe administratës publike me *acquis* të BE-së dhe standardet e BE-së me synimin për anëtarësimin e ardhshëm në Union.

Prandaj, Mekanizmi i ri do të plotësojë qasjen IPA III duke u fokusuar në përcaktuesit specifikë për rritjen sociale dhe ekonomike.

Për më tepër, ndërkohë që IPA III fokusohet në një proces programimi të bazuar në performancë, ky mekanizëm i ri do të ketë një mekanizëm pagese të bazuar në kushtëzimin *ex ante*, duke përzier në mënyrë inovative grantet dhe huatë, të cilat do të sjellin një nxitje më të fortë për zbatimin e reformave kyçe strukturore nga Përfituesit.

Për të përfituar plotësisht nga mundësitë e Planit të Rritjes, çdo Përfitues do të përgatisë një Agjendë Reformash, e cila do të përcaktojë masat kryesore që secili Përfitues synon të ndërmarrë gjatë periudhës 2024-2027 për të përshpejtuar konvergjencën socio-ekonomike me BE-në. Agjenda e Reformës do të konsultohet, vlerësohet dhe miratohet nga Komisioni.

Agjenda e Reformës do të jetë në përputhje me strategjinë e rritjes së Përfituesit në përputhje me rrugën e zgjerimit. Ajo do të sjellë përpara reformat kryesore themelore të identifikuar në procesin e anëtarësimit, si dhe një numër të kufizuar **reformash qendrore socio-ekonomike** të identifikuar në Programet e mëparshme të Reformës Ekonomike, të cilat do të integrohen më tej në Agjendat e Reformës. Kjo do të artikulohet me një përshpejtim të **investimeve** përkatëse dhe të lidhura sipas Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, një pasqyrim rajonal i Global Gateway.

Këto investime do të shpërndahen përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) dhe sektorëve të synuar që do të funksionojnë si shumëfishues kryesorë për zhvillimin socio-ekonomik: lidhshmëria, duke përfshirë transportin, energjinë, tranzicionin e gjelbër dhe digjital, arsimin dhe zhvillimin e shkathtësive. Projektet apo programet përkatëse do të zbatohen në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat zhvillimore të shteteve të BE-së dhe do të tërheqin investime shtesë nga ato dhe nga sektori privat.

Mekanizmi për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor për periudhën 2024-2027 është kështu plotësues i IPA III. Kjo është krijuar si instrument fleksibël, i përshtatur me objektivin e përshpejtitimit të reformave themelore socio-ekonomike dhe afrimit të rajonit me BE-në, duke siguruar njëkohësisht parashikueshmëri, transparencë, dhe llogaridhënie për fondet.

Ekziston mundësia që Ballkani Perëndimor të zbatojë reforma të synuara në bashkëpunim me Shtetet Anëtare të BE-së nën Instrumentin e Mbështetjes Teknike (TSI), pasi bashkëpunimi me shtetet anëtare në zbatimin e reformave mund të kontribuojë në pranimin dhe integrimin e tyre të përshpejtuar. Komisioni do të vlerësojë rezultatet e projektit pilot aktual të TSI-së me vendet kandidatë dhe kandidatët potencialë dhe do të eksplorojë më tej se si të lehtësojë pjesëmarrjen e tyre në projektet e reformave të shumë vendeve në kuadër të TSI-së.

Ky mekanizëm i propozuar do t'i mundësojë Unionit të përputhet me ambiciet e tij politike me përfitimin e tij financiar, në përputhje me zotimin e tij afatgjatë *vis-à-vis* Përfituesve të Ballkanit Perëndimor në rrugëtimin e tyre drejt anëtarësimit në BE.

Burimet maksimale për zbatimin e Mekanizmit do të jenë 6 miliardë euro (me çmime aktuale) për 2024-2027 për të gjitha llojet e mbështetjes, nga të cilat deri në 2 miliardë euro do të jenë në mbështetje të pakthyeshme dhe 4 miliardë euro në kredi koncesionare të dhëna nga Unioni. Provizionimi i detyrimeve financiare në Fondin e Përbashkët për Provizionim për kreditë do të vijë nga mbështetja e pakthyeshme prej 2 miliardë eurosh.

Për sa i përket komponentit të mbështetjes së pakthyeshme, Mekanizmi do të financohet nga burime shtesë sipas Kreut 6 të Kornizës Financiare Shumëvjeçare (MFF) si pjesë e Rishikimit Afatmesëm të MFF-së. Rrjedhimisht, propozimi për një ndryshim të Rregullores së MFF-së¹ përcakton se një shtesë prej 2 miliardë eurosh do të vihen në dispozicion nën Kreun 6 për ndihmën për Ballkanin Perëndimor.

Mekanizmi i ri do të zbatohet nëpërmjet mekanizmave të ofrimit që janë përzgjedhur për të maksimizuar arritjen e shpejtë të reformave dhe investimeve përkatëse, duke ruajtur kontrollet

¹ COM(2023) 337 final.

e nevojshme dhe duke minimizuar barrën administrative për Komisionin, Përfituesit dhe partnerët e tjerë zbatues.

Mbështetja do të ofrohet përmes dy mekanizmave të realizimit: 1) Mbështetje direkte për buxhetet kombëtare të Përfituesve dhe 2) Mbështetje për investimet në infrastrukturë nëpërmjet WBIF-së.

Si minimum, gjysma e shumës së përgjithshme në dispozicion për mbështetjen e Mekanizmit, rreth 3 miliardë euro, do t'i akordohen gradualisht WBIF-së duke përfshirë të gjithë shumën e mbështetjes së pakthyeshme minus shumat që do të rezervohen për asistencën teknike dhe administrative për zbatimin e Mekanizmit si dhe për provizionimin, siç përshkruhet më tej më poshtë.

Kanalizimi i fondeve për investime kapitale nëpërmjet WBIF-së do të ofrojë siguri shtesë ndaj rreziqeve fiduciare, duke pasur parasysh se WBIF ka sisteme të përcaktuar mirë të kontrollit financiar duke u mbështetur gjithashtu në standardet e kontrollit të vlerësuara nga shtylla të institucioneve financiare zbatuese. WBIF-ja ofron një kuadër të vetëm bashkëpunimi ndërmjet Komisionit Evropian, donatorëve dypalësh të Shteteve Anëtare dhe institucioneve financiare. Të gjitha investimet do të bazohen në parimet "mos bëj dëm" dhe "mos lër askënd prapa" dhe do të kontribuojnë në objektivin më të gjerë për të ndihmuar rajonin të kalojë drejt një ekonomie të gjelbër, neutrale ndaj klimës, resiliente ndaj klimës, digjitale dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me Rregullat dhe standardet e BE-së.

Ndërkohë që dy mekanizmat e përmendur më sipër do të thithin pjesën më të madhe të fondeve, një shumë e vogël e buxhetit të Instrumentit (që korrespondon me 1.5%) do të rezervohet për asistencë teknike dhe administrative për zbatimin e Mekanizmit, si veprimet përgatitore, monitorimi, aktivitetet e kontrollit, auditimit dhe vlerësimin, të cilat kërkohen për menaxhimin e Mekanizmit dhe arritjen e objektivave të tij, në veçanti studime, takime ekspertësh, trajnime, konsultime me autoritetet përfituese, konferenca, konsultime me palët e interesit, veprime informuese dhe komunikuese, duke përfshirë veprimet gjithëpërfshirëse në terren dhe komunikimin korporativ të prioritetëve politike të Unionit. Shpenzimet mund të mbulojnë gjithashtu kostot e aktivitetëve të tjera mbështetëse si kontrolli i cilësisë dhe monitorimi i projekteve ose programeve në terren dhe kostot e këshillimit të kolegëve dhe ekspertëve për vlerësimin dhe zbatimin e reformave dhe investimeve.

Disbursimet e drejtpërdrejta në buxhetet kombëtare dhe vënia në dispozicion e fondeve për paraqitjen e propozimeve për investime për opinionin e Bordit Operativ të WBIF-së do t'i nënshtrohen progresit dhe përmbushjes së **kushteve të pagesës** të specifikuara në Agjendat e Reformës së Përfituesve. Kushtet e pagesës do të marrin formën e një sërë hapash cilësorë dhe sasiorë dhe një afati kohor përkatës për disbursimet që lidhen me reformat specifike socio-ekonomike për të stimuluar rritjen, për t'i vendosur partnerët në një rrugë të qëndrueshme konvergjence dhe për t'i orientuar ata drejt reformave specifike që lidhen me bazat e procesit të zgjerimit duke përfshirë sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Stabiliteti makro-financiar, menaxhimi i shëndoshë i financave publike, transparencja dhe mbikëqyrja e buxhetit janë kushte të përgjithshme për pagesë që duhet të përmbushen për çdo lirim të fondeve. **Pagesat do të kryhen sipas një plani fiks gjashtëmuor**, bazuar në kërkesat e justifikuar siç duhet për lirimin e fondeve të paraqitura nga Përfituesit dhe pas verifikimit nga Komisioni të përmbushjes së kushteve përkatëse të pagesës. Në rast se kushtet e pagesës nuk plotësohen, Komisioni do të pezullojë ose do të zbrësë një shumë përkatëse nga pagesa.

Lëshimi i fondeve përkatëse të pezulluara mund të bëhet gjatë 12 muajve pas afatit fillestar të përcaktuar në Agjendën e Reformës, me kusht që të jenë plotësuar kushtet e pagesës. Ky afat

duhet të zgjatet në 24 muaj në vitin e parë të zbatimit. Përndryshe, shumica përkatëse mund të zbritet nga alokimi i Përfituesit dhe të rishpërndahet midis Përfituesve të tjerë në vitet në vijim.

Për financimin e siguruar për buxhetet kombëtare, propozohet një sistem shumë nivelesh auditimi dhe kontrolli: së pari, nëse kërkohet, reforma e sistemeve të auditimit dhe kontrollit të Përfituesve do të përfshihet si pjesë e reformave në kuadër të Agjendës së Reformës së vendeve; së dyti, Komisioni do të jetë në gjendje të kryejë rishikime të detajuara të sistemeve të sistemeve kombëtare për zbatimin e buxhetit në çdo moment të ciklit të projektit. Aty ku zbatimi bëhet përmes menaxhimit indirekt ose përmes kombinimit (WBIF), Komisioni do të mbështetet në sistemet e kontrollit të entiteteve të vlerësuara me shtylla, të cilat përfshijnë institucionet financiare ndërkombëtare ose bankat e zhvillimit të Shteteve Anëtare të BE-së, përveç sistemeve të veta.

- **Përputhshmëria me dispozitat ekzistuese të politikave në fushën e politikave**

Mbështetja në kuadër të këtij Mekanizmi do të jetë në përputhje dhe plotësuese me format e tjera të mbështetjes dypalëshe për Ballkanin Perëndimor të ofruar përmes instrumenteve të tjera të BE-së, në veçanti IPA III. Ai do të ndërtojë dhe përforcojë mbështetjen aktuale dhe do t'i lejojë rajonit të përshpejtojë zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Për të arritur objektivat dhe synimet e tij, theks i veçantë duhet t'i kushtohet sektorëve që ka të ngjarë të funksionojnë si shumëfishues kyç për zhvillimin social dhe ekonomik: koneksioni, transporti, energjia, tranzicioni digjital, inovacioni, arsimi dhe zhvillimi i shkathtësive.

- **Konsistenca me politikat e tjera të Unionit**

Zbatimi i Rregullores do të jetë në përputhje me fushat e tjera të veprimit të jashtëm dhe politikat e jashtme (p.sh. negociatat e zgjerimit, asistenca e para-anëtarësimit). Ky mekanizëm do të plotësojë këto përpjekje duke përshpejtuar konvergjencën socio-ekonomike të rajonit me BE-në në përgatitje për anëtarësimin e ardhshëm në Union.

2. **BAZA LIGJORE, SUBSIDIARITETI DHE PROPORCIONALITETI**

- **Baza ligjore**

Ky propozim bazohet në nenin 212 dhe nenin 322 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Ai paraqitet nga Komisioni në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 294 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

- **Subsidiariteti (për kompetencë joekskluzive)**

Mekanizmi i propozuar synon mbështetjen për Përfituesit e Ballkanit Perëndimor për të arritur konvergjencën me Bashkimin Evropian në kontekstin e politikës së zgjerimit, prandaj Unioni është në pozicionin më të mirë për të ofruar një ndihmë të tillë. Përgatitja e vendeve kandidatë dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në Union mund të trajtohet më së miri në nivel të Unionit.

Duke pasur parasysh shkallën e ndihmës së nevojshme, BE-ja është në një pozicion unik për të ofruar ndihmë të jashtme për Ballkanin Perëndimor në afat të gjatë kohore, të koordinuar dhe të parashikueshme. BE-ja mund të shfrytëzojë kapacitetin e saj huamarrës për të dhënë hua për Ballkanin Perëndimor me kushte të favorshme, si dhe për të ofruar mbështetje dhe garanci të pakthyeshme në një perspektivë shumëvjeçare.

Me praninë e saj në terren nëpërmjet delegacioneve të saj, BE-ja mund të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse në informacionin mbi zhvillimet që prekin çdo Përfitues. Kjo i mundëson BE-së të jetë vazhdimisht e vetëdijshme për nevojat dhe rrethanat e reja dhe, për rrjedhojë, të përshtatë mbështetjen sipas nevojave në zhvillim, duke u koordinuar ngushtë me donatorë të tjerë dypalësh ose shumëpalësh.

• **Proporcionaliteti**

Propozimi është në përputhje me parimin e proporcionalitetit në atë që nuk shkon përtej minimumit të kërkuar për të arritur objektivat e deklaruara në nivel evropian dhe që është i nevojshëm për këtë qëllim.

Ky mekanizëm propozohet si një veprim i synuar për të mbështetur reformat e përsheptuara në një rajon që duhet të arrijë hapin me BE-në për të siguruar një zgjerim të qetë dhe reciprokisht me përfitim të BE-së. Struktura e saj mbështetet për aq sa është e mundur në strukturën ekzistuese mbështetëse (IPA III), ose të njëjtat modele financimi (p.sh. WBIF), ose bazuar në instrumente ekzistuese, por të thjeshtuara (instrumente të bazuara në performancë).

• **Zgjedhja e instrumentit**

Në përputhje me nenin 212 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian, i cili përcakton procedurën e zakonshme legislative që do të përdoret për miratimin e masave për zbatimin e bashkëpunimit me vendet e treta, propozimi merr formën e një rregulloreje, e cila siguron zbatimin uniform të saj, natyrën detyruese në tërësinë e saj dhe zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë.

3. REZULTATET E VLERËSIMIT EX-POST, KONSULTIMIT ME PALËT E INTERESIT DHE VLERËSIMET E NDIKIMIT

• **Konsultime me palët e interesit:**

Një konsultim formal me palët e interesit nuk mund të kryhej për shkak të urgjencës së përgatitjes së propozimit në mënyrë që ai të mund të miratohet në kohën e duhur nga bashkëligjvënësit për ta bërë atë funksional në vitin 2024.

BE-ja do të sigurojë komunikimin dhe dukshmërinë e duhur rreth objektivave dhe veprimeve të kryera brenda fushëveprimit të këtij Mekanizmi, në Ballkanin Perëndimor, brenda Unionit dhe më gjerë.

• **Vlerësimi i ndikimit**

Për shkak të urgjencës politike të propozimit, asnjë vlerësim i ndikimit nuk mund të kryhet. Një dokument analitik në formën e një dokumenti pune të stafit që paraqet provat pas propozimit do të përgatitet brenda tre muajve nga miratimi i nismës.

• **Të drejtat themelore**

Një parakusht për dhënien e mbështetjes sipas instrumentit është që Përfituesit e Ballkanit Perëndimor të vazhdojnë të respektojnë mekanizmat efektivë demokratikë dhe institucionet e tij, duke përfshirë një sistem parlamentar shumëpartiak, sundimin e ligjit dhe të garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Angazhimi për reforma dhe vullneti i fortë politik i shprehur nga autoritetet janë shenja pozitive, të konfirmuara në vlerësimin e Komisionit për gjendjen e përgatitjeve të partnerëve për anëtarësimin në BE, përfshirë në Komunikatën e Komisionit për Paketën e Zgjerimit 2023.

4. IMPLIKIMET BUXHETORE

Burimet maksimale për t'u ofruar përmes Mekanizmit do të jenë 6 miliardë euro për 2024-2027 për të gjitha llojet e mbështetjes, nga të cilat 2 miliardë euro do të jenë në mbështetje të pakthyeshme dhe 4 miliardë euro në kredi koncesionare të dhëna nga Unioni.

Për sa i përket komponentit granteve, ky Mekanizëm do të financohet nga burime shtesë të propozuara sipas Kreut 6 të Kornizës Financiare Shumëvjeçare (MFF) si pjesë e Rishikimit Afatmesëm të MFF-së. Amendamenti i Rregullores së MFF-së parashikon një shumë shtesë prej 2 miliardë eurosh në dispozicion në kuadër të Kreut 6 për asistencën ndaj Ballkanit Perëndimor.

Huatë do të provizionohen në Fondin e Përbashkët të Provizionimit në masën 9% dhe provizionimi do të financohet nga 2 miliardë euro të propozuara si pjesë e Rishikimit Afatmesëm të MFF-së që do të përbëjë portofolin financiar të këtij Mekanizmi.

1.5% e komponentit të mbështetjes së pakthyeshme (30 milionë euro) do të ndahet për shpenzimet e asistencës teknike dhe administrative në lidhje me menaxhimin e Mekanizmit, duke përfshirë monitorimin, komunikimin, auditimin dhe vlerësimin.

Pjesa e mbetur e mbështetjes së pakthyeshme, si dhe komponenti i huasë do të ndahet në bazë të formulës në Shtojcën I, duke kombinuar pjesën e popullsisë së një Përfituesi mbi popullsinë e përgjithshme të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe BPV-në mesatare për kokë banori për rajonin e Ballkanit Perëndimor mbi BPV-në për kokë banori të Përfituesit përkatës, kështu duke peshuar dy faktorët përkatësisht me 60% dhe 40%.

5. ELEMENTE TË TJERA

• Zbatimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Rregullorja përcakton dispozita të detajuara në lidhje me zbatimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

Zbatimi sipas instrumentit do të bëhet sipas formularëve dhe metodave zbatuese të përcaktuara në Rregulloren Financiare.

Komisioni do të monitorojë vazhdimisht zbatimin e Mekanizmit. Me respektim të plotë të Traktateve, shërbimet e Komisionit do të punojnë me Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) në kontekstin e zbatimit të Mekanizmit për të siguruar qëndrueshmërinë e veprimit të jashtëm të Unionit. Në raport me Serbinë dhe Kosovën, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Siguri/Zëvendëspresidenti i Komisionit, në cilësinë e Lehtësuesit të Dialogut për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, do të japë vlerësimin e tij/saj.

Një sistem monitorimi i bazuar në kriteret e përcaktuara nga Komisioni duhet të vendoset nga Përfituesit dhe pritët që ata t'i raportojnë Komisionit çdo vit për zbatimin e agjendave të tyre të reformës. Kjo do të përfshijë raportimin për arritjet dhe progresin drejt arritjes së objektivave të deklaruara të Agjendave të Reformës, për përmirësimet e sistemeve të tyre të kontrollit të brendshëm, për zbatimin e buxhetit të tyre, dhe për çdo shumë të paguar ose keqpërdorur në mënyrë të padrejtë, dhe përfundimisht të rikuperuar nga BE.

Komisioni do t'i sigurojë Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komitetit të përmendur në nenin 27 të Rregullores një vlerësim vjetor të zbatimit të fondeve të ofruara në kuadër të Mekanizmit.

Komisioni do të kryejë gjithashtu një vlerësim *ex-post* të Rregullores.

• **Shpjegim i detajuar i dispozitave specifike të propozimit**

Kjo Rregullore përcakton Mekanizmin për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor.

Kapitulli I (Dispozitat e Përgjithshme) mbulon lëndën e Mekanizmit (neni 1), përkufizimet (neni 2), objektivat e përgjithshme dhe specifike të Mekanizmit (neni 3), parimet e përgjithshme (neni 4) dhe parakushtet për mbështetje. (neni 5).

Kapitulli II përcakton modalitetet e financimit dhe zbatimit të Mekanizmit. Neni 6 përcakton (i) zarin financiar të Mekanizmit në formën e mbështetjes financiare të pakthyeshme dhe në formën e asistencës teknike dhe administrative; dhe (ii) mbështetjen në formë kredish. Neni 7 detajon format e zbatimit të Mekanizmit, pra menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në përputhje me Rregulloren Financiare. Neni 8 përcakton rregullat e përshtatshmërisë dhe të origjinës të zbatueshme për Mekanizmin, ndërkohë që përcakton se rregullat në procedurat e dhënies së kontratës mund të kufizohen për shkak të natyrës së një aktiviteti ose kur një aktivitet ndikon në sigurinë dhe rendin publik. Neni 9 mbulon marrëveshjen e Mekanizmit që do të lidhet ndërmjet Komisionit dhe Përfituesve, duke përcaktuar në veçanti dispozitat e auditimit dhe kontrollit, si dhe detyrimet dhe kushtet për disbursimin e pagesave. Dispozitat për bartjet, këstet vjetore dhe mjetet e zotimeve mbulojnë në nenin 10.

Kapitulli III (Agjendat e Reformës) detajon kërkesat dhe bazat për formulimin e Agjendave të Reformës (neni 11) dhe parimet e përgjithshme për financimin, duke përfshirë kushtet e pagesës për disbursimet (neni 12). Neni 13 detajon Agjendat e Reformës që duhet të dorëzohen nga Përfituesit, procedurën për ta bërë këtë, dhe elementet që duhet të përmbajë Agjenda e Reformës, duke përfshirë reformat dhe fushat e investimeve që do të financohen nga ky mekanizëm, si dhe sistemet për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar parregullsitë, mashtrimet, korrupsionin dhe konfliktet e interesave, gjatë përdorimit të fondeve të ofruara nga Mekanizmi.

Komisioni do të vazhdojë me vlerësimin e agjendave të reformës sipas kritereve të përcaktuara në nenin 14 dhe do të marrë një vendim zbatues siç përshkruhet në nenin 15, i cili përcakton, ndër të tjera, shumën treguese të mbështetjes së huasë që do të disbursohet kundrejt përmbushjes së kënaqshme të kushteve të pagesës, afatit kohor për një përmbushje të tillë dhe parafinancimit për të cilin Përfituesit do të kenë të drejtë. Neni 16 parashikon mundësinë që Komisioni ose Përfituesi të bëjë një propozim për ndryshimin e Agjendës së Reformës.

Neni 17 mbulon marrëveshjet e huasë që do të lidhen ndërmjet Komisionit dhe çdo Përfituesi, dhe rregullat që rregullojnë huamarrjen nga Komisioni në tregje, ndërsa neni 18 përcakton normën e provizionimit dhe procedurën e rishikimit të tij. Neni 19 parashikon mekanizmin për financimin e investimeve në kuadër të Mekanizmit nëpërmjet Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Rregullat për pagesën e parafinancimit për Përfituesit, në varësi të respektimit të parakushteve të përshkruara në nenin 5, përcaktohen në nenin 20. Neni 21 detajon procedurën për disbursimet pas përmbushjes së të dy kushteve të përgjithshme që lidhen me stabilitetin makro-financiar, menaxhimin e shëndoshë të financave publike, transparencën dhe mbikëqyrjen e buxhetit dhe kushtet e pagesës të përcaktuara në agjendat e reformës.

Pagesat do të kryhen në baza gjashtëmujore, pas paraqitjes nga Përfituesi të një kërkesë për lirim të fondeve që tregojnë përmbushjen e kënaqshme të kushteve përkatëse të pagesës në

formën e hapave cilësor dhe sasior që do të ndërmerren. Në rast të vlerësimit negativ nga Komisioni, një pjesë e shumës që korrespondon me kushtet e paplotësuara të pagesës do të mbahet në burim. Fondet e mbajtura në burim do të liroheshin vetëm pasi Përfituesi të ketë justifikuar siç duhet, si pjesë e kërkesës së mëvonshme për lirim të fondeve, se ka marrë masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kënaqshme të kushteve përkatëse të pagesës. Nëse nuk është kështu, Komisioni mund t'i rishpërndajë shumat midis Përfituesve të tjerë. Ky nen përcakton gjithashtu se asnjë shumë nuk do të paguhet për hapat cilësorë ose sasiorë të paplotësuar deri më 31 dhjetor 2028, ndërkohë që autorizon Komisionin të zvogëlojë shumat nëse preken interesat financiare të Unionit ose nëse Përfituesit kanë shkelur seriozisht një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet e lidhura në kuadër të Mekanizmit.

Kapitulli IV (Mbrojtja e interesave financiare të Unionit) parashtron dispozitat që duhen ndjekur nga Komisioni dhe Përfituesit për të siguruar kontrolle efektive mbi zbatimin e Mekanizmit. Neni 22 detajon detyrimet që duhet të pasqyrohen në marrëveshjet e Mekanizmit dhe kredisë, të cilat do të përfshijnë masat e duhura për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar mashtrimin, korrupsionin, konfliktet e interesave dhe parregullsitë që prekin interesat financiare të Unionit, për të shmangur financimin e dyfishtë dhe për të marrë veprime ligjore për të rikuperuar fondet që janë përvetësuar, mbledhja e të dhënave adekuate për përfituesit e fondeve në kuadër të Mekanizmit dhe të drejtat që do t'i jepen Komisionit, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (EPPO) aty ku është e aplikueshme. Ky nen i jep gjithashtu të drejtë Komisionit të zvogëlojë ose rikuperojë shumat nëse preken interesat financiare të Unionit ose nëse Përfituesit kanë shkelur rëndë një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet e lidhura në kuadër të Mekanizmit. Neni 23 përcakton dispozitat për sistemet e kontrollit të brendshëm të Përfituesve.

Kapitulli V (Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi) mbulon dispozitat për përcaktimin e indikatorëve dhe kornizave të rezultateve të përdorura në monitorimin dhe vlerësimin (neni 24) dhe vlerësimin *ex-post* të Mekanizmit (neni 25).

Kapitulli VI (Dispozitat përfundimtare) përcakton ushtrimin e delegimit të kompetencave në lidhje me normën e provizionimit (neni 26), procedurën e komitologjisë (neni 27), dispozitat për informimin, komunikimin dhe publicitetin (neni 28) dhe hyrjen në fuqi (neni 29).

Propozim për

RREGULLORE TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT

për krijimin e Mekanizmit për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti nenin 212 dhe nenin 322(1) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Gjykatës së Auditorëve,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Është në interesin e përbashkët të Unionit dhe partnerëve të tij të Ballkanit Perëndimor² të avancojnë përpjekjet për të reformuar sistemet politike, ligjore dhe ekonomike të këtyre të fundit me synimin për anëtarësimin e tyre të ardhshëm në Union. Perspektiva e anëtarësimit në Union ka një efekt të fuqishëm transformues, duke përfshirë ndryshime pozitive demokratike, politike, ekonomike dhe shoqërore.
- (2) Ekziston nevoja për të paraqitur disa nga avantazhet e anëtarësimit në Union përpara anëtarësimit. Konvergjencia ekonomike është në qendrën e këtyre përfitimeve. Aktualisht, konvergjencia e Ballkanit Perëndimor në termat e BPV-së për kokë banori të shprehura në standardet e fuqisë blerëse mbetet e ulët midis 30% dhe 50% të mesatares së Unionit dhe nuk po përparon mjaftueshëm shpejt.
- (3) Për të reduktuar këtë pabarazi, Komisioni Evropian miratoi një komunikatë mbi një plan të rritjes për Ballkanin Perëndimor bazuar në katër shtylla: (a) rritjen e integritit me tregun e vetëm të BE-së; (b) nxitjen e integritit ekonomik rajonal, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, duke zbatuar plotësisht Planin e Veprimit të Përbashkët Rajonal të Tregut; (c) thellimin e reformave që synojnë përshtetësimin e rritjes në rajon, promovimin e konvergjencës ekonomike dhe forcimin e stabilitetit rajonal; dhe (d) krijimin e një Instrumenti të ri Financimi: Mekanizmi për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor.
- (4) Zbatimi i atij Plani të Rritjes kërkon rritje të fondeve nën një Instrument të ri Financimi të dedikuar, Mekanizmi për Reforma dhe Rritje Ekonomike, për të ndihmuar rajonin në zbatimin e reformave që promovojnë rritjen, integritimin rajonal dhe tregun e përbashkët rajonal.
- (5) Për të arritur këto qëllime, theks i veçantë në lidhje me fushat e investimeve duhet t'i kushtohet sektorëve që ka të ngjarë të funksionojnë si shumëfishues kyç për zhvillimin

² Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Serbi.

*Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës

social dhe ekonomik: lidhja, duke përfshirë transportin, energjinë, tranzicionin e gjelbër dhe digjital, arsimin dhe zhvillimin e shkathtësive.

- (6) Infrastruktura e transportit është thelbësore për të përmirësuar lidhjen ndërmjet partnerëve të Ballkanit Perëndimor dhe me BE-në. Ajo duhet të kontribuojë në integrimin e rajonit në Union. Në propozimin e tij për rishikimin e kornizës trans-evropiane të transportit (TEN-T), Komisioni përfshiu një Korridor të ri që përshkon rajonin e Ballkanit Perëndimor (korridori Mesdhe Perëndimor-Lindor). Rrjeti TEN-T duhet të jetë referenca për financimin e infrastrukturës së transportit në rajon.
- (7) Mekanizmi duhet të mbështesë investimet dhe reformat që promovojnë rrugën e përfituesve drejt transformimit digjital të ekonomisë dhe shoqërisë në përputhje me vizionin e BE-së për vitin 2030 të paraqitur në komunikimin e Komisionit '2030 Digital Compass: Rruga Evropiane për Dekadën Digjitale'³. Ajo duhet të përpiqet të lehtësojë arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave digjitale në lidhje me Unionin. Siç është përshkruar nga Komisioni në komunikimin e tij të 15 qershorit 2023⁴, pako e sigurisë kibernetike 5G duhet të jetë referenca për financimin e BE-së për të garantuar sigurinë, resiliencën dhe mbrojtjen e integritetit të infrastrukturës digjitale në rajon.
- (8) Mbështetja e Unionit në kuadër të Mekanizmit nuk duhet të zëvendësojë mbështetjen dypalëshe dhe rajonale të ofruar sipas Rregullores (BE) 2021/1529 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁵, duke u fokusuar në përgatitjen e Përfituesve për anëtarësim në Union, por ta plotësojë atë dhe t'i shtohet, duke përdorur mekanizmat dhe strukturat ekzistuese aty ku është e mundur. Qasja duhet të bazohet në metodologjinë ekzistuese të zgjerimit, veçanërisht Metodologjinë e Rishikuar 2020⁶ dhe Planin Ekonomik dhe të Investimeve⁷ nga i njëjti vit.
- (9) Mbështetja në kuadër të Mekanizmit duhet të ofrohet për të përmbushur objektivat e përgjithshme dhe specifike, bazuar në kriteret e përcaktuara dhe me kushte të qarta pagese. Objektivat e përgjithshme të Mekanizmit duhet të jenë përshpejtimi i integritetit ekonomik rajonal, integrimi progresiv me tregun e vetëm të Unionit, konvergjenca socio-ekonomike e ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe përafrimi me ligjet, rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e Unionit me synim anëtarësimin në Union. Mekanizmi duhet të ndihmojë gjithashtu në përshpejtimin e reformave në lidhje me bazat e procesit të zgjerimit, duke përfshirë sundimin e ligjit, prokurimin publik dhe kontrollin e ndihmës shtetërore, menaxhimin e financave publike dhe luftën kundër korrupsionit. Këto objektiva duhet të ndiqen në një mënyrë reciprokisht përforcuese.
- (10) Mekanizmi duhet të promovojë parimet e efektivitetit të zhvillimit, duke respektuar shtesën ndaj mbështetjes së ofruar sipas programeve dhe instrumenteve të tjera të Unionit dhe duke u përpjekur të shmangë dyfishimin ndërmjet asistencës sipas kësaj rregulloreje dhe asistencës tjetër të ofruar nga Unioni, Shtetet Anëtare, vendet e treta, organizatat dhe entitetet shumëpalëshe dhe rajonale.
- (11) Mekanizmi duhet të sigurojë konsistencë dhe mbështetje për objektivat e përgjithshme të veprimit të jashtëm të Unionit siç përcaktohet në nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian, duke përfshirë respektimin e të drejtave themelore siç parashikohen në Kartën

³ COM(2021)118 final.

⁴ 'Zbatimi i pakos së sigurisë kibernetike 5G', COM(2023)4049 përfundimtar.

⁵ Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA III), OJ L 330, 20.9.2021, f. 1, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/2021/1529/oj>.

⁶ COM (2022) 57 final.

⁷ COM(2020) 641 final.

e të Drejtave Themelore të BE-së. Ajo veçanërisht do të sigurojë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.

- (12) Aktivitetet në kuadër të Mekanizmit duhet të mbështesin përparimin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Marrëveshjes së Parisit dhe Konventës Kornizë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Diversitetin Biologjik dhe Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Shkretëtirëzimit dhe nuk duhet të kontribuojnë në degradim të mjedisit ose dëmtim të mjedisit ose klimës. Masat e financuara në kuadër të Mekanizmit duhet të jenë në përputhje me Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës të Përfituesve, Kontributin e tyre Kombëtar të Përcaktuar dhe ambicien për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050. Mekanizmi duhet të kontribuojë në veprimet zbutëse dhe në aftësinë për t'u përshtatur me efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe për të nxitur resiliencën klimatike.
- (13) Zbatimi i kësaj rregulloreje duhet të udhëhiqet nga parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, siç janë përpunuar në strategjitë e Unionit për Barazi. Ajo duhet të promovojë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, dhe të kërkojë të mbrojë dhe promovojë të drejtat e grave dhe vajzave në përputhje me planet e veprimit gjinor të BE-së dhe konkluzionet përkatëse të Këshillit dhe konventat ndërkombëtare. Zbatimi i Mekanizmit duhet të jetë në përputhje me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të sigurojë qasshmërisë në investimet dhe asistencën teknike të saj.
- (14) Kjo rregullore duhet të promovojë Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor⁸ duke përforcuar mbrojtjen e mjedisit, duke kontribuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe duke rritur resiliencën ndaj ndryshimeve klimatike dhe duke përshpejtuar zhvendosjen drejt një ekonomie me karbon të ulët.
- (15) Duke reflektuar Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane si strategjinë e rritjes së qëndrueshme të Evropës dhe rëndësinë e trajtimit të objektivave të klimës dhe biodiversitetit në përputhje me angazhimet e Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Mekanizmi duhet të kontribuojë në arritjen e objektivit të përgjithshëm prej 30% të shpenzimeve buxhetore të Unionit duke mbështetur objektivat e klimës dhe 7.5% në vitin 2024 dhe 10% në vitin 2026 dhe 2027 për objektivat e biodiversitetit. Të paktën 37% e mbështetjes financiare të pakthyeshme e kanalizuar përmes WBIF duhet t'i përgjigjet objektivave të klimës. Mekanizmi duhet të mbështesë aktivitetet që respektojnë plotësisht standardet dhe prioritetet klimatike dhe mjedisore të Unionit dhe parimin "mos bëni dëm të madh" sipas kuptimit të nenit 17 të Rregullores (BE) 2020/852⁹.
- (16) Komisioni, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe Përfituesit, duhet të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në dhënien e ndihmës, duke përfshirë zbatimin e sistemeve të duhura të kontrollit të brendshëm dhe politikave kundër mashtrimit. Mbështetja në kuadër të Mekanizmit duhet të vihet në dispozicion me parakushtet që secili prej Përfituesve të vazhdojë të respektojë dhe të mbështesë mekanizmat dhe institucionet efektive demokratike, duke përfshirë një sistem parlamentar shumëpartiak dhe sundimin e ligjit, dhe të garantojë respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Një tjetër parakusht duhet të jetë që Serbia dhe Kosova të angazhohen në mënyrë konstruktive në normalizimin e marrëdhënieve të

⁸ SWD(2020)223 përfundimtar, 6.10.2020

⁹ Rregullorja (BE) 2020/852 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 qershor 2020 mbi krijimin e një kuadri për të lehtësuar investimet e qëndrueshme dhe ndryshimin e Rregullores (BE) 2019/2088, OJ L 198, 22.6. 2020, fq. 13.

tyre me synimin për të zbatuar plotësisht të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Shtojca e Zbatimit të saj si dhe të gjitha Marrëveshjet e Dialogut të kaluar dhe të angazhohen në negociata për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.

- (17) Shuma e përgjithshme maksimale për mbështetjen e Unionit përmes Mekanizmit duhet të jetë 6 miliardë euro në çmime aktuale për periudhën nga viti 2024 deri në 2027, nga të cilat deri në 2 miliardë euro në mbështetje të pakthyeshme dhe 4 miliardë euro në asistencë financiare koncesionare dhënë nga Unioni dhe e provizionuar nga 2 miliardë euro. Të paktën gjysma e shumës totale duhet të ndahet përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), duke përfshirë të gjithë shumën e mbështetjes së pakthyeshme, minus 1.5% të asistencës teknike dhe shumat e nevojshme për provizionimin e kredive.
- (18) Kjo rregullore përcakton një zarf financiar për të gjithë kohëzgjatjen e këtij Instrumenti, i cili do të përbëjë shumën kryesore të referencës, sipas kuptimit të pikës 18 të Marrëveshjes Ndërinstitucionale të datës 16 dhjetor 2020 ndërmjet Parlamentit Evropian, Këshillit të Bashkimi Evropian dhe Komisioni Evropian për disiplinën buxhetore, për bashkëpunimin në çështjet buxhetore dhe për menaxhimin e shëndoshë financiar, si dhe për burimet e reja vetanake, duke përfshirë një udhërrëfyes drejt prezantimit të burimeve të reja vetanake, për Parlamentin Evropian dhe Këshillin gjatë procedurës buxhetore vjetore.
- (19) Detyrimi financiar nga huatë sipas këtij mekanizmi nuk duhet të mbështetet nga Garancia e Veprimit të Jashtëm, me përjashtim të nenit 31(3), fjalia e dytë e Rregullores (BE) 2021/947. Lloji i mbështetjes së huasë sipas këtij mekanizmi duhet të përbëjë ndihmë financiare sipas kuptimit të nenit 220(1) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046. Një shumë treguese e financimit për çdo Përfitues duhet të llogaritet bazuar në formulën e përcaktuar në Shtojcën I, duke kombinuar pjeësn e popullsisë së një Përfituesi mbi popullsinë e përgjithshme të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe BPV-në mesatare për kokë banori për rajonin e Ballkanit Perëndimor mbi BPV-në për kokë banori të Përfituesit përkatës, kështu duke peshuar dy faktorët përkatësisht me 60% dhe 40%. Nëse kushtet e pagesës për lirim të fondeve nuk plotësohen, Komisioni mund të rishpërndajë një pjesë ose të gjithë shumën tek Përfituesit e tjerë.
- (20) Rregullat financiare horizontale të miratuara nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në bazë të nenit 322 TFEU duhet të zbatohen për këtë rregullore. Këto rregulla përcaktohen në Rregulloren (BE, Euratom) 2018/1046 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹⁰ dhe përcaktojnë në veçanti procedurën për krijimin dhe zbatimin e buxhetit nëpërmjet granteve, prokurimeve, menaxhimit indirekt, ndihmës financiare, operacioneve të kombinuara dhe rimbursimit të ekspertëve të jashtëm, dhe të sigurohen kontrole mbi përgjegjësinë e aktorëve financiarë.
- (21) Kufizimet e përshtatshmërisë në procedurat e dhënies së kontratës në kuadër të Mekanizmit duhet të lejohen për shkak të natyrës specifike të aktivitetit ose kur aktiviteti ndikon në sigurinë ose rendin publik.

¹⁰ Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 korrik 2018 mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Unionit, duke ndryshuar Rregulloret (BE) Nr. 1296/2013, (BE) Nr. 1301/2013, (BE) Nr. 1303/2013, (BE) Nr. 1304/2013, (BE) Nr. 1309/2013, (BE) Nr. 1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, (BE) Nr. 283/2014, dhe Vendimi Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizimi i Rregullores (BE, Euratom) Nr. 966/20 (OJ L 193, 30.7.2018, fq. 1, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/2018/1046/oj>).

- (22) Për të siguruar zbatim efikas të Mekanizmit, duke përfshirë lehtësimin e integritimit të përfituesve të Ballkanit Perëndimor në zinxhirët evropianë të vlerës, të gjitha furnizimet dhe materialet e financuara dhe të prokuruar në kuadër të këtij mekanizmi duhet të vijnë nga Shtetet Anëtare, Përfituesit, palët kontraktuese në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendet e mbuluara nga Shtojca I e Rregullores (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹¹ dhe Shtojca I e Rregullores (BE) 2021/1529 dhe vendet për të cilat qasja reciproke për asistencën e jashtme në Përfituesit vendoset nga Komisioni, përveç rasteve kur furnizimet dhe materialet nuk mund të sigurohen në kushte të arsyeshme në ndonjë prej këtyre vendeve.
- (23) Duke respektuar parimin se buxheti i Unionit përcaktohet çdo vit, duhet të sigurohet mundësia për të aplikuar fleksibilitetet në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) 2018/1046 për politika të tjera, duke përfshirë bartjet dhe rizotimet e fondeve, për të siguruar përdorimin efikas të fondeve të Unionit, duke maksimizuar kështu fondet e Unionit të disponueshme në kuadër të Mekanizmit.
- (24) Zbatimi i Mekanizmit për Ballkanin Perëndimor duhet të mbështetet nga një grup koherent dhe i prioritetizuar i reformave të synuara dhe prioritetëve të investimeve në secilin Përfitues të Ballkanit Perëndimor (agjendë reformash), duke ofruar një kornizë për nxitjen e rritjes socio-ekonomike, të artikuluar qartë dhe në përputhje me kërkesat e anëtarësimit në BE. Agjenda e Reformës do të shërbejë si një kornizë gjithëpërfshirëse për arritjen e objektivave të këtij mekanizmi.
- (25) Disbursimi i mbështetjes së Unionit duhet të kushtëzohet nga pajtueshmëria me kushtet e pagesës dhe nga progresi i matshëm në zbatimin e reformave të përcaktuara në agjendat e reformave të vlerësuara dhe të miratuara zyrtarisht nga Komisioni. Lirimi i fondeve duhet të strukturohet në përputhje me rrethanat, duke reflektuar objektivat e Mekanizmit.
- (26) Agjendat e Reformës duhet të përfshijnë masat e synuara të reformës dhe fushat prioritare të investimeve, së bashku me kushtet e pagesës në formën e hapave cilësorë dhe sasiorë që tregojnë progres ose përfundim të kënaqshëm të këtyre masave, dhe një afat kohor tregues për zbatimin e këtyre masave. Këto hapa duhet të planifikohen jo më vonë se 31 gusht 2027, megjithëse përfundimi i përgjithshëm i masave të cilave u referohen hapa të tillë mund të shtrihet përtej vitit 2027, por jo më vonë se 31 dhjetor 2028.
- (27) Agjendat e Reformës duhet të përfshijnë një shpjegim të sistemit të Përfituesit për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar në mënyrë efektive parregullsitë, korrupsionin, mashtrimin dhe konfliktet e interesave, kur përdoren fondet e ofruara në kuadër të Mekanizmit, dhe marrëveshjet që synojnë të shmangin financimin e dyfishtë nga Mekanizmi dhe programet e tjera të Unionit, si dhe nga donatorë të tjerë.
- (28) Masat sipas Agjendave të Reformës duhet, kur është e përshtatshme, të kontribuojnë në përmirësimin e një sistemi efikas të menaxhimit dhe kontrollit të financave publike, në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit të organizuar, dhe në një sistem efektiv të kontrollit të ndihmës shtetërore, duke synuar sigurimin e kushteve të drejta për të gjitha ndërmarrjet. Masat e tilla duhet të zbatohen nga Përfituesi deri në një datë

¹¹ Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale, duke ndryshuar dhe shfuqizuar Vendimin Nr. 466/2014/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizimi i Rregullores (BE) 2017/1601 i Parlamentit Evropian dhe Rregullores së Këshillit dhe Këshillit (KE, Euratom) Nr 480/2009 (OJ L 209, 14.6.2021, p. 1, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/2021/947/oj>).

indikative e cila mund të caktohet, e përshtatshme për secilën masë, në fazën e hershme të zbatimit të Mekanizmit.

- (29) Komisioni duhet të vlerësojë çdo Agjendë Reforme bazuar në listën e kritereve të përcaktuara në këtë Rregullore. Për të siguruar kushte uniforme për zbatimin e kësaj Rregulloreje, kompetencat zbatuese duhet t'i jepen Komisionit për të miratuar ato Agjenda të Reformës. Këto kompetenca duhet të ushtrohen në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 182/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹². Komisioni do të marrë parasysh siç duhet vendimin e Këshillit 2010/427/BE dhe rolin e EEAS aty ku është e përshtatshme, dhe në veçanti kur monitoron përmbushjen e parakushtit për mbështetjen e Unionit.
- (30) Vendimi zbatues i Komisionit i përmendur në këtë rregullore duhet në të njëjtën kohë të përbëjë një program pune sipas kuptimit të nenit 110(2) të Rregullores Financiare në lidhje me shumën e mbështetjes financiare të pakthyeshme sipas kësaj rregulloreje.
- (31) Duke pasur parasysh nevojën për fleksibilitet në zbatimin e Mekanizmit, duhet të jetë e mundur që një Përfitues t'i bëjë një kërkesë të arsyetuar Komisionit për të ndryshuar vendimin zbatues, kur Agjenda e Reformës, duke përfshirë kushtet përkatëse të pagesës, nuk është më e arritshme, pjesërisht ose tërësisht, për shkak të rrethanave objektive. Përfituesi duhet të jetë në gjendje të bëjë një kërkesë të arsyetuar për të ndryshuar Agjendën e Reformës, duke përfshirë edhe propozimin e shtojcave kur është e nevojshme.
- (32) Komisioni duhet të jetë në gjendje të ndryshojë vendimin zbatues, në veçanti për të marrë parasysh një ndryshim të shumave të disponueshme.
- (33) Në rast të rishpërndarjes së mbështetjes sipas këtij mekanizmi, e cila do të çonte në mbështetje shtesë për një Përfitues, ky Përfitues duhet të paraqesë një Agjendë Reforme të rishikuar me masa shtesë që duhen arritur.
- (34) Një Marrëveshje e Mekanizmit duhet të lidhet me secilin Përfitues për të përcaktuar parimet e bashkëpunimit financiar ndërmjet Unionit dhe Përfituesit, dhe për të specifikuar mekanizmat e nevojshëm në lidhje me kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin dhe auditimin e financimit të Unionit sipas Mekanizmit, rregullat për taksat, detyrimet dhe tarifat dhe masat për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe korrigjimin e parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Rrjedhimisht, një marrëveshje kredie duhet të lidhet gjithashtu me çdo Përfitues, duke përcaktuar dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e financimit të dhënë në formën e kredisë.
- (35) Mbështetja financiare për Agjendat e Reformës duhet të jetë e mundur në formën e një kredie. Në kontekstin e nevojave financiare të Ballkanit Perëndimor, është e përshtatshme të organizohet ndihma financiare sipas strategjisë së financimit të larmishëm të parashikuar në nenin 220a të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 dhe të vendosur si një metodë e vetme financimi në të, e cila pritet të rrisë likuiditetin e obligacioneve të Unionit dhe atraktivitetin dhe kosto-efektivitetin e emetimit të Unionit.
- (36) Është e përshtatshme që përfituesve t'u jepen hua me kushte shumë koncesionare me një kohëzgjatje maksimale prej 40 vjetësh dhe të mos fillohet shlyerja e kryegjësë përpara

¹² Rregullorja (BE) Nr. 182/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shkurt 2011 që përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me mekanizmat për kontrollin nga Shtetet Anëtare të ushtrimit të kompetencave zbatuese të Komisionit (OJ L 55, 28.2.2011, fq. 13, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/2011/182/oj>).

vitit 2034. Është gjithashtu e përshtatshme që të shmanget nga neni 220(4), i Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.

- (37) Duke marrë parasysh se rreziqet financiare që lidhen me mbështetjen për Përfituesit në formën e huave sipas këtij Instrumenti janë të krahasueshme me rreziqet financiare që lidhen me operacionet e huadhënies sipas Rregullores (BE) 2021/947, provizionimi për detyrimin financiar prej kredive sipas kësaj Rregullore duhet të konstituohet në normën 9%, në përputhje me nenin 211 të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 dhe financimi i provizionimit duhet të merret nga zarfi prej 2 miliardë eurosh në kuadër të këtij mekanizmi.
- (38) Për të siguruar që norma e provizionimit të mbetet e përshtatshme për rreziqet financiare, kompetenca për të miratuar akte në përputhje me nenin 290 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian duhet t'i delegohet Komisionit në lidhje me ndryshimin e normës së provizionimit. Është e një rëndësie të veçantë që Komisioni të kryejë konsultimet e duhura gjatë punës së tij përgatitore, duke përfshirë në nivel ekspertësh dhe që ato konsultime të kryhen në përputhje me parimet e përcaktuara në Marrëveshjen Ndërinstitucionale për Ligjbërje më të Mirë të datës 13 prill 2016¹³. Në veçanti, për të siguruar pjesëmarrje të barabartë në përgatitjen e akteve të deleguara, Parlamenti Evropian dhe Këshilli marrin të gjitha dokumentet në të njëjtën kohë me ekspertët e Shteteve Anëtare dhe ekspertët e tyre kanë qasje sistematike në takimet e grupeve të ekspertëve të Komisionit që merren me përgatitjen e akteve të deleguara.
- (39) Për të maksimizuar ndikimin e mbështetjes financiare të Unionit për të tërhequr investime shtesë dhe për të siguruar kontrollin e BE-së mbi shpenzimet, investimet në infrastrukturë që mbështesin Agjendat e Reformës duhet të zbatohen nëpërmjet WBIF. Projektet ose programet individuale duhet t'i paraqiten Bordit Operativ të WBIF-it për mendimin e tij vetëm pas plotësimit të kushteve përkatëse të pagesës të përcaktuara në Agjendat e Reformës. Në rast të mospërmbushjes së kushteve përkatëse të pagesës për investimet brenda një viti, Komisioni mund të rishpërndajë fondet e investimit sipas WBIF midis Përfituesve të mbetur.
- (40) Për të siguruar që Përfituesit të disponojnë fondet fillestare për zbatimin e reformave të para, çdo Përfitues duhet të ketë qasje deri në 7% të shumës totale të parashikuar nga kjo ndihmë financiare e Mekanizmit në formën e një para-financimi, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe respektimit të parakushteve për mbështetjen në kuadër të Mekanizmit.
- (41) Është e rëndësishme të garantohet fleksibiliteti dhe programueshmëria në ofrimin e mbështetjes së Unionit për Përfituesit e Ballkanit Perëndimor. Për këtë qëllim, fondet në kuadër të Mekanizmit duhet të lirohen sipas një plani fiks gjashtëmuor, në varësi të disponueshmërisë së fondeve, bazuar në një kërkesë për lirim të fondeve të paraqitura nga Përfituesit dhe pas verifikimit nga Komisioni për përmbushjen e kënaqshme si të kushteve të përgjithshme që lidhen me stabilitetin makro-financiar, menaxhimin e shëndoshë të financave publike, transparencën dhe mbikëqyrjen e buxhetit ashtu edhe të kushteve përkatëse të pagesës. Kur një kusht pagese nuk plotësohet në përputhje me afatin kohor tregues të përcaktuar në vendimin për miratimin e Agjendës së Reformës, Komisioni mund të ndalojë një pjesë të fondeve ose tërë fondet që korrespondojnë me atë kusht. Lirimi i fondeve përkatëse të mbajtura në burim mund të bëhet gjatë dritares së ardhshme për lirim të fondeve dhe deri në dymbëdhjetë muaj pas afatit fillestar të përcaktuar në afatin kohor tregues, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e pagesës.

¹³ OJ L123, 12.5.2016, fq.1.

Në vitin e parë të zbatimit, ky afat duhet të zgjatet në 24 muaj nga vlerësimi fillestar negativ.

- (42) Me përjashtim të nenit 116 pika 2 dhe 5 të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, është e përshtatshme të caktohet afati i pagesës për kontributet në buxhetet e shtetit duke filluar nga data e komunikimit të vendim që autorizon disbursimin për Përfituesin dhe për të përjashtuar pagesën e interesit të vonesës së pagesës nga Komisioni për Përfituesin.
- (43) Në kuadrin e masave kufizuese të Unionit, të miratuara në bazë të nenit 29 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU) dhe 215(2) të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFEU), nuk ka fonde ose burimet ekonomike mund të vihen në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për ose në dobi të personave juridikë, entiteteve ose organeve të caktuara. Prandaj, entitetet e tilla të përcaktuara dhe entitetet në pronësi ose të kontrolluara prej tyre nuk mund të mbështeten nga ky Mekanizëm.
- (44) Në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) 2018/1046, Rregulloren (BE, Euratom) 883/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹⁴ dhe Rregulloret e Këshillit (KE, Euratom) Nr. 2988/95¹⁵, (KE, Euratom) Nr 2185/96¹⁶ dhe (BE) 2017/1939¹⁷, interesat financiare të Unionit duhet të mbrohen me anë të masave proporcionale, duke përfshirë masat në lidhje me parandalimin, zbulimin, korrigjimin dhe hetimin e parregullsisve, mashtrimeve, korrupsionit, konfliktit të interesit, financimit të dyfishtë, deri në rikuperimin e fondeve të humbura, të paguara ose të përdorura gabimisht.
- (45) Në veçanti, në përputhje me Rregulloret (KE, Euratom) Nr. 2185/96 dhe (BE, Euratom) Nr. 883/2013, Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) duhet të jetë në gjendje të kryejë hetime administrative, duke përfshirë kontrollet dhe inspektimet në vend, me synimin për të përcaktuar nëse ka pasur mashtrim, korrupsion ose ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat financiare të Unionit.
- (46) Në përputhje me nenin 129 të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, të drejtat dhe qasja e nevojshme duhet t'i jepet OLAF të Komisionit, Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe, sipas rastit, EPPO-së, duke përfshirë nga palët e treta të përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit.
- (47) Komisioni duhet të sigurojë që interesat financiare të Unionit të mbrohen në mënyrë efektive nga Mekanizmi. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh historikun e gjatë të asistencës financiare të ofruar për Përfituesit e Ballkanit Perëndimor gjithashtu nën menaxhim indirekt dhe duke marrë parasysh përafrimin e tyre gradual me standardet dhe praktikën e kontrollit të brendshëm të Unionit, Komisioni mund të mbështetet në një masë të madhe në operacionin e sistemeve kombëtare të kontrollit të brendshëm dhe parandalimit të mashtrimit. Në veçanti, Komisioni dhe OLAF duhet të informohen pa

¹⁴ Rregullorja (BE, Euratom) Nr. 883/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 shtator 2013 në lidhje me hetimet e kryera nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr. 1073/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe Rregullorja e Këshillit (Euratom) Nr. 1074/1999 (OJ L 248, 18.9.2013, fq. 1, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/2013/883/oj>).

¹⁵ Rregullorja e Këshillit (KE, Euratom) Nr. 2988/95 e datës 18 dhjetor 1995 për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane (OJ L 312, 23.12.1995, fq. 1, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/1995/2988/oj>).

¹⁶ Rregullorja e Këshillit (Euratom, EC) Nr. 2185/96 e datës 11 nëntor 1996 në lidhje me kontrollet dhe inspektimet në vend të kryera nga Komisioni për të mbrojtur interesat financiare të Komuniteteve Evropiane kundër mashtrimit dhe parregullsisve të tjera (OJ L 292, 15.11.1996, fq. 2, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/1996/2185/oj>).

¹⁷ Rregullorja e Këshillit (BE) 2017/1939 e datës 12 tetor 2017 për zbatimin e bashkëpunimit të zgjeruar për krijimin e Zyrës së Prokurorit Publik Evropian ('EPPO') (OJ L 283, 31.10.2017, fq. 1, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/2017/1939/oj>).

vonesë për të gjitha rastet e dyshuara të parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit dhe konfliktit të interesave që ndikojnë në zbatimin e fondeve në kuadër të Mekanizmit.

- (48) Për më tepër, përfituesit duhet t'i raportojnë Komisionit parregullsitë, duke përfshirë mashtrimin, të cilat kanë qenë objekt i një konstatimi parësor administrativ ose gjyqësor, pa vonesë, dhe ta mbajnë këtë të fundit të informuar për ecurinë e procedimit administrativ dhe ligjor. Me objektivin e përafrimit me praktikën e mira në Shtetet Anëtare, ky raportim duhet të bëhet me mjete elektronike, duke përdorur Sistemin e Menaxhimit të Parregullsive, të krijuar nga Komisioni.
- (49) Çdo Përfitues duhet të krijojë një sistem monitorimi që ushqehet me një raport gjashtëmujor të përmbushjes së kushteve të pagesës të Agjendës së tij që shoqëron kërkesën gjashtëmujore për lirin e fondeve. Përfituesit duhet të mbledhin dhe të sigurojnë qasje në të dhëna dhe informacione që mundësojnë parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit dhe konflikteve të interesit, në lidhje me masat e mbështetura nga Mekanizmi.
- (50) Komisioni duhet të sigurojë se ekzistojnë mekanizma të qartë monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë efektive në zbatimin e buxhetit të Unionit dhe për të siguruar vlerësim efektiv të progresit drejt arritjes së objektivave të kësaj rregulloreje.
- (51) Komisioni duhet t'i ofrojë Parlamentit Evropian dhe Komitetit të përmendur në këtë Rregullore një raport vjetor mbi progresin në zbatimin e Rregullores dhe të Mekanizmit.
- (52) Komisioni duhet të kryejë një vlerësim të Mekanizmit pas përfundimit të saj.
- (53) Kapacitetet e komunikimit të Përfituesve duhet të rriten në mënyrë që të sigurohet mbështetje e fortë dhe e lirë pluraliste dhe publike për vlerat e Unionit dhe përfitimet dhe detyrimet e anëtarësimit të mundshëm në Union, duke trajtuar dezinformimin dhe manipulimin e informacionit. Dukshmëria e financimit të Unionit duhet të sigurohet gjithashtu.
- (54) Meqenëse objektivat e kësaj Rregulloreje nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare, por mund të arrihen më mirë në nivel të Unionit, Unioni mund të miratojë masa, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të TEU-së. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit siç përcaktohet në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për të arritur këto objektiva.
- (55) Duke pasur parasysh objektivat e përgjithshme ambicioze të këtij mekanizmi brenda një periudhe të shkurtër zbatimi, kjo rregullore duhet të hyjë në fuqi në ditën pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian,

KANË MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

KAPITULLI I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Lënda

1. Kjo Rregullore përcakton Mekanizmin për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor ('Mekanizmin).

Ajo përcakton objektivat e Mekanizmit, financimin e tij, buxhetin për periudhën 2024-2027, format e financimit nga Unioni sipas saj dhe rregullat për sigurimin e këtij financimi.

2. Mekanizmi do të ofrojë ndihmë për Ballkanin Perëndimor për realizimin e reformave socio-ekonomike dhe investimeve për zbatimin e agjendave të tyre përkatëse të reformave, siç përcaktohet në Kapitullin III.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Përfitues" nënkupton njërën nga sa vijon: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën*, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë.
2. "Paketa e Zgjerimit" nënkupton komunikatën vjetore mbi politikën e zgjerimit të BE-së dhe dokumentet shoqëruese të punës së stafit.
3. "Marrëveshja e Mekanizmit" nënkupton një marrëveshje të lidhur ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit që përcakton parimet e bashkëpunimit financiar ndërmjet Përfituesit dhe Komisionit sipas kësaj Rregulloreje. Kjo marrëveshje përbën një marrëveshje financimi sipas kuptimit të nenit 114(2) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 në lidhje me fondet sipas nenit 6(2) pika a.
4. "Marrëveshja e huasë" do të thotë një marrëveshje e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit që përcakton kushtet e zbatueshme për mbështetjen e Mekanizmit.
5. "Agjendat e reformave" do të thotë një paketë gjithëpërfshirëse e një grupi koherent dhe të prioritetizuar të reformave të synuara dhe fushave prioritare të investimeve në secilin Përfitues, duke përfshirë kushtet e pagesës që tregojnë progres të kënaqshëm ose përfundimin e këtyre masave, dhe një afat kohor tregues për zbatimin e këtyre masave.
6. "Masa" nënkupton reformat dhe investimet në kuadër të Agjendave të Reformës në përputhje me Kapitullin III.
7. "Kushtet e pagesës" do të thotë kushtet për lirimin e fondeve që marrin formën e hapave cilësorë ose sasiorë të vëzhgueshëm dhe të matshëm për t'u zbatuar nga Përfituesit, siç përcaktohet në Agjendat e Reformës në përputhje me Kapitullin III si kushte për lirimin e fondeve;
8. "Operacion i kombinuar" nënkupton një operacion të mbështetur nga buxheti i Unionit që kombinon forma të pakthyeshme të mbështetjes, nga buxheti i Unionit me forma të ripagueshme mbështetjeje nga zhvillimi ose institucione të tjera të financave publike, ose nga institucionet financiare tregtare dhe investitorët.

Neni 3 Objektivat e Mekanizmit

1. Objektivat e përgjithshme të Mekanizmit do të jenë:
 - (a) përshpejtimi i integritimit ekonomik rajonal dhe integritimit progresiv me tregun e vetëm të Unionit;

* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/1999 dhe Opininionin e GJND-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

- (b) përshpejtimi i konvergencës socio-ekonomike të ekonomive të përfituesve me Unionin;
- (c) përshpejtimi i përafrimit me vlerat, ligjet, rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e Unionit me synimin për anëtarësimin në Union

2. Objektivat specifike të Mekanizmit përfshijnë:

- (a) përshpejtimin e tranzicionit të Përfituesve drejt ekonomive të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, të afta për t'i bërë ballë presioneve konkurruese të tregut të tregut të vetëm të Unionit dhe në një mjedis të qëndrueshëm investimi;
- (b) nxitjen e integritimit ekonomik rajonal në veçanti nëpërmjet progresit në krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal;
- (c) nxitjen e integritimit ekonomik të Përfituesve me tregun e vetëm të Unionit;
- (d) mbështetjen për integrim ekonomik rajonal dhe integrim të zgjeruar me tregun e vetëm të BE-së përmes përmirësimit të lidhjes në rajon në përputhje me Rrjetet Transevropiane;
- (e) përshpejtimin e tranzicionit të gjelbër në përputhje me Agjendën e Gjelbër 2020 për Ballkanin Perëndimor dhe duke mbuluar të gjithë sektorët ekonomikë, veçanërisht energjinë, duke përfshirë tranzicionin drejt ekonomisë së dekarbonizuar, neutrale ndaj klimës, resiliente ndaj klimës dhe ekonomisë qarkore;
- (f) promovimin e transformimit digjital si një mundësi për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje gjithëpërfshirëse;
- (g) nxitjen e inovacionit, veçanërisht për NVM-të dhe në mbështetje të tranzicionit të gjelbër dhe atij digjital;
- (h) nxitjen e arsimit cilësor, trajnimit, rikualifikimit dhe ngritjes së shkathtësive dhe politikat e punësimit;
- (i) forcimin e mëtejshëm të bazave të procesit të zgjerimit, duke përfshirë sundimin e ligjit, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, nëpërmjet promovimit të një gjyqësori të pavarur, sigurimit të përforcuar, luftës kundër mashtrimit, korrupsionit, krimi të organizuar dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, evazionit fiskal dhe mashtrimit fiskal; pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare; forcimin e lirisë së mediave dhe lirisë akademike dhe një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile; nxitjen e dialogut social; promovimin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin dhe tolerancën, për të siguruar dhe forcuar respektimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave;
- (j) përforcimin e efektivitetit të administratës publike dhe mbështetjen e transparencës, reformave strukturore dhe qeverisjes së mirë në të gjitha nivelet, duke përfshirë fushat e menaxhimit të financave publike dhe prokurimit publik dhe kontrollit të ndihmës shtetërore; mbështetjen e iniciativave dhe organeve të përfshira në mbështetjen dhe zbatimin e drejtësisë ndërkombëtare në Përfituesit e Ballkanit Perëndimor.

Neni 4
Parimet e përgjithshme

1. Bashkëpunimi në kuadër të Mekanizmit do të bazohet dhe do të promovojë parimet e efektivitetit të zhvillimit, në të gjitha modalitetet, përkatësisht pronësinë e prioriteteve të zhvillimit nga Përfituesit, fokusin në rezultate, partneritete gjithëpërfshirëse, transparencë dhe llogaridhënie reciproke. Bashkëpunimi do të bazohet në shpërndarjen dhe përdorimin efektiv dhe efikas të burimeve.
2. Mbështetja nga Mekanizmi do të jetë shtesë ndaj mbështetjes së ofruar sipas programeve dhe instrumenteve të tjera të Unionit. Aktivitetet e pranueshme për financim sipas kësaj rregulloreje mund të marrin mbështetje nga programe dhe instrumente të tjera të Unionit me kusht që kjo mbështetje të mos mbulojë të njëjtën kosto.
3. Për të promovuar komplementaritetin dhe efikasitetin e veprimit të tyre, Komisioni dhe Shtetet Anëtare do të bashkëpunojnë dhe do të përpiqen të shmangin dyfishimin ndërmjet ndihmës sipas kësaj Rregulloreje dhe asistencës tjetër të ofruar nga Unioni, Shtetet Anëtare, vendet e treta, organizatat shumëpalëshe dhe rajonale dhe entitete, si organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiare ndërkombëtare përkatëse, agjencitë dhe donatorët jo të Unionit, në përputhje me parimet e vendosura për forcimin e koordinimit operacional në fushën e ndihmës së jashtme, duke përfshirë koordinimin e zgjeruar me Shtetet Anëtare në nivel lokal.
4. Aktivitetet në kuadër të Mekanizmit do të përfshijnë zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, biodiversitetin dhe mbrojtjen e mjedisit, të drejtat e njeriut, demokracinë, barazinë gjinore dhe, sipas rastit, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, dhe do të mbështesin përparimin drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke promovuar veprime të integruara që mund të krijojnë bashkë-përfitim dhe të përmbushin objektivat e shumëfishta në mënyrë koherente. Ato do të shmangin pasuritë e bllokuara dhe do të udhëhiqen nga parimet e "mos bëj dëm" dhe "mos lërë askënd prapa", si dhe nga qasja e integritit të qëndrueshmërisë që mbështet Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane.
5. Përfituesit dhe Komisioni duhet të sigurojnë që barazia midis burrave dhe grave, integrimi gjinor dhe integrimi i një perspektive gjinore të merren parasysh dhe të promovohen gjatë përgatitjes së Agjendave të Reformës dhe zbatimit të Mekanizmit. Përfituesit dhe Komisioni do të ndërmarrin hapat e duhur për të parandaluar çdo diskriminim të bazuar në gjini, origjinë racore ose etnike, fe ose besim, paaftësi, moshë ose orientim seksual. Komisioni do të raportojë për këto masa në kontekstin e raportimit të tij të rregullt sipas Planeve të Veprimit Gjinor.
6. Mekanizmi nuk do të mbështesë aktivitete ose masa që janë të papajtueshme me Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës së Përfituesve, Kontributin e tyre të Përcaktuar Kombëtar sipas Marrëveshjes së Parisit dhe ambicien për të arritur neutralitetin ndaj klimës deri në vitin 2050 ose që nxisin investimet në lëndët djegëse fosile, ose që shkaktojnë efekte të mëdha negative në mjedis ose në klimë.
7. Komisioni, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe Përfituesit, do të kontribuojë në zbatimin e angazhimeve të Unionit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në dhënien e asistencës, duke përfshirë përmes promovimit zbatimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe politikave kundër mashtrimit, dhe duke vënë në dispozicion informacionin mbi vëllimin dhe shpërndarjen e ndihmës përmes

databazave të bazuara në ueb, dhe do të sigurojë që të dhënat të jenë të krahasueshme dhe të mund të qasen, ndahen dhe publikohen lehtësisht.

Neni 5

Parakushtet për mbështetjen nga Unioni

1. Parakushtet për mbështetjen në kuadër të Mekanizmit do të jenë që Përfituesit të vazhdojnë të mbështesin dhe respektojnë mekanizmat efektivë demokratikë, duke përfshirë një sistem parlamentar shumëpartiak dhe sundimin e ligjit, dhe të garantojnë respektimin e të gjitha detyrimeve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Një tjetër parakusht duhet të jetë që Serbia dhe Kosova të angazhohen në mënyrë konstruktive në normalizimin e marrëdhënieve të tyre me synimin për të zbatuar plotësisht të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Shtojca e Zbatimit të saj si dhe të gjitha Marrëveshjet e Dialogut të kaluar dhe të angazhohen në negociata për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.
2. Komisioni do të monitorojë përmbushjen e parakushteve të përcaktuara në paragrafin 1 përpara se fondet të lirohen për Përfituesit në kuadër të Mekanizmit dhe gjatë gjithë periudhës së mbështetjes së ofruar në kuadër të Mekanizmit duke marrë parasysh siç duhet Paketën e fundit të Zgjerimit. Komisioni mund të miratojë një vendim duke konkluduar se disa nga këto parakushte nuk janë përmbushur, dhe në veçanti, të ndalojë lirimin e fondeve të përmendura në nenin 21, pavarësisht nga përmbushja e kushteve të pagesës të përmendura në nenin 16(3).

KAPITULLI II

Financimi dhe zbatimi

Neni 6

Buxheti

1. Burimet që do të vihen në dispozicion nëpërmjet Mekanizmit, në përputhje me paragrafët 2 dhe 3, nuk do të kalojnë 6 000 000 000 euro për periudhën nga viti 2024 deri në 2027.
2. Zarfi financiar për zbatimin e Mekanizmit do të jetë 2 000 000 000 euro për periudhën nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2027, nga të cilat:
 - (a) 98.5% në formën e mbështetjes financiare të pakthyeshme për Përfituesit për zbatimin e Agjendave të Reformës;
 - (b) 1.5% për shpenzimet sipas paragrafit 6.
3. Mbështetja në formën e një kredie, do të jetë e disponueshme për një shumë deri në 4 000 000 000 euro për periudhën nga 1 janari 2024 deri më 31 dhjetor 2027. Kjo shumë nuk do të jetë pjesë e shumës së Garancisë së Veprimit të Jashtëm sipas kuptimit të nenit 31(4) të Rregullores Nr. 2021/947.
4. Komisioni do të përcaktojë shumën fillestare indikative të financimit në dispozicion për çdo Përfitues, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Shtojcën I, në vendimin zbatues përkatës të përmendur në nenin 15, llogaritur në bazë të të dhënave më të fundit të disponueshme në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje në

përputhje me Nenin 29. Shumat indikative mund të ndryshojnë gjatë zbatimit në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 21.

5. Në bazë të nenit 19, shuma e fondeve të vëna në dispozicion sipas Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) të përmendur në nenin 12 të Rregullores (BE) 2021/1529¹⁸ do të jetë së paku 50% e shumës së përgjithshme në paragrafin 1. Ky kontribut përfshin të gjithë shumën e mbështetjes financiare të pakthyeshme siç përmendet në paragrafin 2 pika (a) të këtij neni pas zbritjes së shumës së provizionimit.
6. Burimet e përmendura në paragrafin 2 pika (b) mund të përdoren për asistencë teknike dhe administrative për zbatimin e Mekanizmit, të tilla si veprimet përgatitore, monitorimi, kontrolli, auditimi dhe aktivitetet e vlerësimit, të cilat kërkohen për menaxhimin e Mekanizmit dhe arritjen e objektivave të saj, në veçanti studime, takime ekspertësh, trajnime, konsultime me autoritetet përfituese, konferenca, konsultime me palët e interesit, veprime të informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë veprime gjithëpërfshirëse në terren, dhe komunikim korporativ të prioritetëve politike të Unionit, deri më tani pasi ato lidhen me objektivat e kësaj rregulloreje, shpenzimet e lidhura me rrjetet e TI-së me fokus përpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, mjetet e teknologjisë së informacionit të korporatave, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera në selinë qendrore dhe delegacionet e Unionit për mbështetjen administrative dhe koordinuese të nevojshme për Mekanizmin. Përfundimisht, shpenzimet mund të mbulojnë gjithashtu kostot e aktivitetëve të tjera mbështetëse si kontrolli i cilësisë dhe monitorimi i projekteve ose programeve në terren dhe kostot e këshillimit të kolegëve dhe ekspertëve për vlerësimin dhe zbatimin e reformave dhe investimeve.

Neni 7

Zbatimi dhe format e financimit nga Unioni

1. Mekanizmi do të zbatohet në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) 2018/1046, qoftë në menaxhim të drejtpërdrejtë ose në menaxhim indirekt me cilindo nga entitetet e përmendura në nenin 62(1), nënparagrafi i parë, pika (c) e Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.
2. Financimi i Unionit mund të sigurohet në cilëndo nga format e përcaktuara në Rregulloren (BE, Euratom) 2018/1046, në veçanti asistencë financiare, grante, prokurime dhe operacione të kombinuara.
3. Në varësi të kapacitetit të kërkuar operacional dhe financiar, entiteti i besuar që zbaton operacionet e kombinuara mund të jetë Banka Evropiane e Investimeve ose Fondi Evropian i Investimeve, institucione financiare ndërkombëtare shumëpalëshe, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ose institucione financiare dypalëshe evropiane, si p.sh. bankat për zhvillim. Kurdoherë që është e mundur, zbatimi i operacioneve të kombinuara në kuadër të Mekanizmit do të plotësohet me forma shtesë të mbështetjes financiare, nga shtetet anëtare ose nga palët e treta.

Neni 8

Rregullat për pranueshmërinë e personave dhe entiteteve, origjinën e furnizimit dhe materialeve dhe kufizimin sipas Mekanizmit

1. Pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve për aktivitetet e financuara në kuadër të Mekanizmit do të jetë e hapur për organizatat ndërkombëtare

¹⁸ Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA III), OJ L330, 20.09.2021.

dhe rajonale dhe për të gjithë personat fizikë që janë nënshtruar dhe për personat juridikë që janë krijuar efektivisht në:

(a) Shtetet Anëtare, Përfituesit, Palët kontraktuese të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendet e mbuluara nga Shtojca I e Rregullores (BE) 2021/947 dhe Shtojca I e Rregullores (BE) 2021/1529;

(b) vendet për të cilat qasja reciproke në ndihmën e jashtme në Përfituesit është vendosur nga Komisioni.

2. Qasja reciproke e përmendur në paragrafin 1 pika (b), mund të jepet për një periudhë të kufizuar prej të paktën një viti, sa herë që një vend u jep të drejtën në kushte të barabarta entiteteve nga Unioni dhe nga vendet e pranueshme në kuadër të Mekanizmit.

Komisioni do të vendosë për qasjen reciproke pas konsultimit me Përfituesin përkatës.

3. Të gjitha furnizimet dhe materialet e financuara dhe të prokuruar sipas këtij mekanizmi do të kenë origjinën nga ndonjë vend i referuar në paragrafin 1 pika (a) dhe pika (b), përveç nëse furnizimet dhe materialet nuk mund të sigurohen në kushte të arsyeshme në ndonjë nga ato vende. Përveç kësaj, zbatohen rregullat për kufizimet në paragrafin 6.

4. Rregullat e përshtatshmërisë sipas këtij neni nuk do të zbatohen dhe nuk do të krijojnë kufizime të kombësisë për personat fizikë të punësuar ose të kontraktuar ligjërisht nga një kontraktues i kualifikuar ose, kur është e zbatueshme, nënkontraktor, përveç rasteve kur kufizimet e kombësisë bazohen në rregullat e parashikuara në paragrafin 6.

5. Për veprimet e bashkëfinancuara nga një entitet ose të zbatuara në menaxhim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me entitetet siç përmendet në nenin 62(1), pika (c) e Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, rregullat e këtyre entiteteve do të aplikohen gjithashtu. Kjo nuk cenon kufizimet e përcaktuara sipas paragrafit 6, të cilat do të pasqyrohen siç duhet në marrëveshjet e lidhura me këto entitete.

6. Rregullat e përshtatshmërisë dhe origjina e furnizimeve dhe materialeve të përmendura në paragrafët 1 dhe 3 dhe kombësia e personave fizikë të përmendur në paragrafin 4 mund të kufizohen në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike ose natyrën e entiteteve juridike që marrin pjesë në procedurat e dhënies si dhe në lidhje me origjinën gjeografike të furnizimeve dhe materialeve, në rastet e mëposhtme:

(a) kur kufizime të tilla kërkohen për shkak të natyrës specifike dhe/ose objektivave të aktivitetit ose procedurës specifike të dhënies së kontratës dhe/ose kur këto kufizime janë të nevojshme për zbatimin efektiv të veprimit;

(b) kur veprimi ose procedurat specifike të dhënies së çmimit prekin sigurinë ose rendin publik, veçanërisht në lidhje me pasuritë dhe interesat strategjike të Unionit, të Shteteve Anëtare të tij ose të ndonjë prej Përfituesve, duke përfshirë sigurinë, resiliencën dhe mbrojtjen e integritetit të infrastrukturës digjitale (duke përfshirë infrastrukturën e rrjetit 5G), sistemet e komunikimit dhe informacionit, dhe zinxhirët e furnizimit përkatës.

7. Aplikantët e tenderit dhe kandidatët nga vendet që nuk kualifikohen mund të pranohen si të kualifikuar në rast urgjence ose kur shërbimet nuk janë të disponueshme në tregjet e vendeve ose territoreve në fjalë, ose në raste të tjera të vërtetuara siç duhet kur zbatimi i rregullave të pranueshmërisë do të bënte realizimin e një veprimi të pamundur ose tepër të vështirë.

Neni 9
Marrëveshja e Mekanizmit

1. Komisioni do të lidhë një Marrëveshje për Mekanizmin me secilin Përfitues për zbatimin e Mekanizmit duke përcaktuar detyrimet dhe kushtet e pagesës së Përfituesve për disbursimin e financimit të Mekanizmit.
2. Marrëveshja e Mekanizmit do të plotësohet me marrëveshje kredie në përputhje me nenin 17, duke përcaktuar dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e financimit të dhënë në formën e huave.
3. Financimi do t'u jepet Përfituesve vetëm pasi të kenë hyrë në fuqi Marrëveshjet përkatëse të Mekanizmit dhe Marrëveshjet e aplikueshme të huasë.
4. Marrëveshja e Mekanizmit dhe marrëveshjet e huasë të lidhura me secilin prej Përfituesve, si dhe marrëveshjet e lidhura me personat ose entitetet që marrin fonde të Unionit, do të sigurojnë që të përmbushen detyrimet e përcaktuara në nenin 129 të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.
5. Marrëveshja e Mekanizmit do të përcaktojë dispozitat e nevojshme të detajuara në lidhje me:
 - (a) zotimin e Përfituesit për të përparuar drejt sistemeve më efikase dhe efektive të kontrollit dhe për të forcuar luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, shmangies së taksave, mashtrimit fiskal ose evazionit fiskal;
 - (b) rregullat për lirimin, mbajtjen në burim, reduktimin dhe rishpërndarjen e fondeve në përputhje me nenin 21.
 - (c) aktivitetet që lidhen me menaxhimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin dhe auditimin në kuadër të Mekanizmit, si dhe rishikimet e sistemit, hetimet, masat kundër mashtrimit dhe bashkëpunimin;
 - (d) rregullat për raportimin në Komisionin nëse dhe si janë përmbushur kushtet e pagesës të përmendura në nenin 12;
 - (e) rregullat për tatimet, detyrimet dhe tarifatat në përputhje me nenin 27(9) dhe (10) të Rregullores (BE) 2021/947;
 - (f) masat për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe korrigjimin e parregullsive, mashtrimit, korrupsionit dhe konfliktit të interesit, dhe detyrimin për të njoftuar Komisionin dhe OLAF-in pa vonesë për rastet e dyshuara ose aktuale të parregullsive, mashtrimit, korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe ndjekjen e tyre;
 - (g) detyrimet e përmendura në nenet 22 dhe 23, duke përfshirë rregullat e sakta dhe afatin kohor për mbledhjen e të dhënave nga Përfituesi dhe qasjen për Komisionin dhe OLAF;
 - (h) një procedurë për të siguruar që kërkesat e disbursimit për mbështetjen e kredisë bien brenda shumës së disponueshme të huasë, duke marrë parasysh nenin 6(3);
 - (i) të drejtën e Komisionit për të reduktuar në mënyrë proporcionale mbështetjen e ofruar në kuadër të Mekanizmit dhe për të rikuperuar çdo shumë të shpenzuar për të arritur objektivat e Mekanizmit ose për të kërkuar shlyerjen e parakohshme të huasë, në rastet e parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit dhe konflikteve të interesit që prekin interesat financiare të Unionit që nuk janë korrigjuar nga

Përfituesi, ose të një shkeljeje serioze të një detyrimi që rezulton nga Marrëveshja e Mekanizmit;

- (j) rregullat dhe modalitetet që përfituesit të raportojnë me qëllim të monitorimit të zbatimit të Mekanizmit dhe të vlerësojnë arritjet e objektivave të përcaktuara në nenin 3.

Neni 10

Bartjet, këstet vjetore, mjetet e zotimeve

1. Me përjashtim të nenit 12(4) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, mjetet e pashfrytëzuara të zotimeve dhe pagesave në kuadër të Mekanizmit do të barten automatikisht dhe mund të zotohen dhe përdoren, respektivisht, deri në 31 dhjetor të vitit të ardhshëm financiar. Shuma e bartur do të përdoret së pari në vitin financiar vijues.
2. Komisioni do të informojë Parlamentin Evropian dhe Këshillin për mjetet e zotimeve të mbartura në përputhje me nenin 12(6) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.
3. Me përjashtim të nenit 15 të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 për vënien sërish në dispozicion të mjeteve, mjetet e zotimeve që korrespondojnë me shumën e heqjes së zotimeve të bëra si rezultat i moszbatimit të plotë ose të pjesshëm të një veprimi në kuadër të Mekanizmit do të jenë vënë sërish në dispozicion në dobi të linjës buxhetore të origjinës.
4. Zotimet buxhetore për veprimet që shtrihen në më shumë se një vit financiar mund të ndahen gjatë disa viteve në këste vjetore, në përputhje me nenin 112(2) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.

KAPITULLI III

Agjendat e Reformës

Neni 11

Dorëzimi i Agjendave të Reformës

1. Për të marrë ndonjë mbështetje në kuadër të Mekanizmit, çdo Përfitues do t'i paraqesë Komisionit një Agjendë Reforme për kohëzgjatjen e Mekanizmit, duke u mbështetur në reformat strukturore të pjesës së Programit të fundit të Reformës Ekonomike dhe Udhëzimeve të Përbashkëta të Politikave, të rënë dakord në Dialogun Ekonomik dhe Financiar në maj 2023, strategjia e tij kombëtare e rritjes aty ku është e zbatueshme, metodologjia e rishikuar e zgjerimit, Paketa më e fundit e Zgjerimit dhe Plani Ekonomik dhe Investues për Ballkanin Perëndimor.
2. Agjendat e Reformës do të përcaktojnë reformat që do të ndërmerren nga Përfituesi, si dhe fushat e investimeve, në drejtim të arritjes së objektivave të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në nenin 3. Agjendat e Reformës do të përfshijnë masa për zbatimin e reformave përmes një pakete gjithëpërfshirëse dhe koherente. Në fushat e bazave, duke përfshirë sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat themelore dhe lirinë e shprehjes, Agjendat e Reformës do të pasqyrojnë vlerësimet në Paketën më të fundit të Zgjerimit.

3. Agjenda e Reformës do të jetë në përputhje me kuadrin e fundit të politikës makroekonomike dhe fiskale të paraqitur në Komisionin në kontekstin e Dialogut Ekonomik dhe Financiar me BE-në.
4. Agjendat e Reformës do të jenë në përputhje dhe mbështesin prioritetet e reformës të identifikuara në kontekstin e rrugës së pranimit të Përfituesit, dhe dokumente të tjera përkatëse, si Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës, Kontributi i Përcaktuar Kombëtar sipas Marrëveshjes së Parisit dhe ambicia për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050.
5. Agjendat e Reformës do të respektojnë parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 4.
6. Komisioni do të ftojë përfituesit që të dorëzojnë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje agjendat e tyre përkatëse të reformës.
7. Në rast të një rishpërndarjeje të mbështetjes në kuadër të Mekanizmit që çon në marrjen e mbështetjes shtesë nga një Përfitues, Komisioni do ta ftojë Përfituesin të paraqesë brenda tre muajve një agjendë të rishikuar të reformës për kohëzgjatjen e mbetur të Mekanizmit.

Neni 12

Parimet për financimin sipas Agjendave të Reformës

1. Mekanizmi do të stimulojë zbatimin e Agjendës së Reformës për çdo Përfitues duke vendosur kushte pagese për lirimin e fondeve. Këto kushte pagese do të zbatohen për fondet sipas nenit 6(2) pika (a) dhe nenit 6(3) dhe do të marrin formën e hapave cilësorë ose sasiorë. Hapat e tillë do të pasqyrojnë progresin në reformat specifike socio-ekonomike, duke përfshirë bazat e procesit të zgjerimit dhe sundimit të ligjit, të lidhura me arritjen e objektivave të ndryshëm të Mekanizmit, të përcaktuara në nenin 3, në përputhje me Paketën e fundit të Zgjerimit.
Plotësimi i kushteve të pagesës do të shkaktojë lirimin e plotë ose të pjesshëm të mjeteve, në varësi të shkallës së plotësimit të tyre.
2. Në lidhje me financimin e realizuar nëpërmjet fondit të përmendur në nenin 19, plotësimi i kushteve të pagesës të përmendura në paragrafin 1 do të përbëjë një vërtetim paraprak. Fondet do të paguhen pas marrjes së një kërkesë pagese nga 'menaxherët e fondit të fondit të përbashkët të krijuar nën WBIF për marrjen e kontributeve të donatorëve.
3. Stabiliteti makro-financiar, menaxhimi i shëndoshë i financave publike, transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit janë kushte të përgjithshme për pagesë që duhet të përmbushen për çdo lirim të fondeve.

Neni 13

Përmbajtja e Agjendave të Reformës

1. Agjendat e Reformës do të përcaktojnë në veçanti elementet e mëposhtme, të cilat duhet të arsyetohen dhe të vërtetohen:
 - (a) masat që përbëjnë një përgjigje koherente, gjithëpërfshirëse dhe të balancuar në mënyrë adekuate ndaj objektivave të përcaktuara në nenin 3, duke përfshirë reformat strukturore, investimet dhe masat për të siguruar përputhjen me parakushtet nëse është e nevojshme;

- (b) një shpjegim se si masat janë në përputhje me parimet, strategjitë, planet dhe programet e përmendura në nenin 11;
 - (c) një shpjegim të masës në të cilën masat pritet të kontribuojnë në objektivat klimatike dhe mjedisore;
 - (d) për reformat dhe investimet, një plan kohor tregues dhe kushtet e parashikuara të pagesës për lirim të fondeve në formën e hapave cilësor dhe sasior që do të zbatohen më së voni deri më 31 gusht 2027;
 - (e) masat për monitorimin efektiv, raportimin dhe vlerësimin e Agjendës së Reformës nga Përfituesi, duke përfshirë treguesit përkatës të përcaktuar në paragrafin 2;
 - (f) një shpjegim të sistemit të Përfituesit për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar në mënyrë efektive parregullsitë, mashtrimet, korrupsionin dhe konfliktet e interesave dhe për të zbatuar rregullat e kontrollit të ndihmës shtetërore;
 - (g) çdo informacion tjetër përkatës.
2. Agjendat e Reformës do të bazohen në rezultate dhe do të përfshijnë tregues për vlerësimin e progresit drejt arritjes së objektivave të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në to. Këta indikatorë do të bazohen, aty ku është e përshtatshme dhe relevante, në tregues të miratuar ndërkombëtarisht dhe në ata tashmë të disponueshëm lidhur me politikën e Përfituesve. Treguesit do të jenë gjithashtu koherent për atë që është e mundur, me treguesit kryesorë të korporatës të përfshirë në Kornizën e Rezultateve të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III), në Kornizën e Matjes së Rezultateve të EFSD dhe në WBIF.

Neni 14

Vlerësimi nga Komisioni i Agjendave të Reformës

1. Komisioni do të vlerësojë rëndësinë, gjithëpërfshirjen dhe përshtatshmërinë e Agjendës së Reformës së çdo Përfituesi ose, kur është e zbatueshme, çdo ndryshim të asaj Agjende, pa vonesa të panevojshme. Gjatë kryerjes së vlerësimit të tij, Komisioni vepron në bashkëpunim të ngushtë me Përfituesin në fjalë dhe mund të bëjë vëzhgime ose të kërkojë informacion shtesë.
2. Gjatë vlerësimit të agjendave të reformës, Komisioni do të marrë parasysh informacionin analitik të disponueshëm përkatës për Përfituesin, justifikimin dhe elementet e ofruara nga Përfituesi siç përmendet në nenin 13, si dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm si informacioni i renditur në nenin 11.
3. Në vlerësimin e tij, Komisioni do të marrë parasysh në veçanti kriteret e mëposhtme:
 - (a) nëse Agjenda e Reformës përfaqëson një përgjigje përkatëse, gjithëpërfshirëse, koherente dhe të balancuar në mënyrë adekuate ndaj objektivave të përcaktuara në nenin 3;
 - (b) nëse Agjenda e Reformës mund të pritet të përshpejtojë progresin drejt kapërcimit të hendekut socio-ekonomik midis Përfituesit dhe Unionit, dhe në këtë mënyrë rrit zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe mjedisor dhe mbështet konvergencën drejt standardeve të Unionit;
 - (c) nëse Agjenda e Reformës mund të pritet të përshpejtojë tranzicionin e Përfituesve drejt ekonomive të qëndrueshme, neutrale ndaj klimës dhe resiliente ndaj klimës dhe gjithëpërfshirëse duke përmirësuar lidhjen rajonale, duke bërë përparim në

- tranzicionin binjak të gjelbër dhe digjital, duke përfshirë biodiversitetin, dhe duke rritur inovacionin, arsimin dhe shkathtësitë dhe tregun më të gjerë të punës;
- (d) nëse Agjenda e Reformës mund të pritët të forcojë më tej bazat e procesit të zgjerimit siç përcaktohet në nenin 3.2 pika (i).
 - (e) nëse Agjenda e Reformës trajton siç duhet rreziqet e mundshme në përputhje me parakushtet dhe kushtet e pagesës;
 - (f) nëse kushtet e pagesës të propozuara nga Përfituesi janë të përshtatshme dhe ambicioze, në përputhje me vlerësimin nga Paketa e fundit e Zgjerimit, si dhe mjaftueshëm kuptimplote dhe të qarta për të mundësuar lirim përkatës të fondeve në rast të përmbushjes së tyre dhe nëse treguesit e propozuar të raportimit janë të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për të monitoruar dhe raportuar mbi progresin e bërë drejt objektivave të përgjithshme;
 - (g) nëse aranzhimet e propozuara nga Përfituesi pritët të parandalojnë, zbulojnë dhe korrigjojnë në mënyrë efektive parregullsitë, mashtrimin, korrupsionin dhe konfliktet e interesit, kur përdorin fondet e ofruara në kuadër të Mekanizmit, dhe të sigurojnë që nuk ka financim të dyfishtë nga Mekanizmi dhe programe të tjera të Unionit si dhe donatorë të tjerë nga Mekanizmi dhe programe të tjera të Unionit si dhe donatorë të tjerë.
4. Për qëllime të vlerësimit të Agjendave të Reformës të paraqitura nga Përfituesit, Komisioni mund të asistohet nga ekspertë.

Neni 15

Vendimi zbatues i Komisionit

1. Në rast të një vlerësimi pozitiv, Komisioni miraton me anë të një vendimi zbatues Agjendën e Reformës të paraqitur nga Përfituesi, në përputhje me nenin 14 ose, sipas rastit, të amendamentit të tij të paraqitur në përputhje me nenin 16. Ky vendim zbatues do të miratohet në përputhje me procedurën e ekzaminimit të përmendur në nenin 27(2).
2. Vendimi zbatues i Komisionit do të përcaktojë reformat që do të zbatohen nga Përfituesi, fushat e investimeve që do të mbështeten dhe kushtet e pagesës që rrjedhin nga Agjenda e Reformës, duke përfshirë edhe kalendarin indikativ.
3. Vendimi zbatues i Komisionit gjithashtu përcakton:
 - (a) shumën indikative të fondeve të përgjithshme në dispozicion të Përfituesit dhe këstet e planifikuara që do të lirohen duke përfshirë parafinancimin, të strukturuar në përputhje me nenin 13, pasi Përfituesi të ketë arritur përmbushjen e kënaqshme të kushteve përkatëse të pagesës në formën e hapave cilësorë dhe sasiorë të identifikuar në lidhje me zbatimin e Agjendës së Reformës;
 - (b) ndarjen sipas kësteve të financimit ndërmjet mbështetjes me kredi dhe mbështetjes së pakthyeshme;
 - (c) afatin kohor deri në të cilin duhet të plotësohen kushtet përfundimtare të pagesës për reformat;
 - (d) aranzhimet dhe afatin kohor për monitorimin, raportimin dhe zbatimin e Agjendës së Reformës duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, masat e nevojshme për respektimin e nenit 24;

- (e) treguesit e përmendur në nenin 13(2) për vlerësimin e progresit drejt arritjes së objektivave të përgjithshme dhe specifike në nenin 3;

Neni 16

Amandamente të Agjendave të Reformës

1. Kur Agjenda e Reformës, duke përfshirë kushtet përkatëse të pagesës, nuk është më e arritshme nga Përfituesi, pjesërisht ose tërësisht, për shkak të rrethanave objektive, Përfituesi mund të propozojë një agjendë të ndryshuar të reformës. Në atë rast, Përfituesi mund t'i bëjë një kërkesë të arsyetuar Komisionit për të ndryshuar vendimin e tij zbatues të përmendur në nenin 15(1).
2. Komisioni mund të ndryshojë vendimin zbatues, veçanërisht për të marrë parasysh një ndryshim të shumave të disponueshme në përputhje me parimet sipas nenit 21.
3. Kur Komisioni konsideron se arsyet e paraqitura nga Përfituesi justifikojnë një ndryshim në Agjendën e Reformës, Komisioni do të vlerësojë agjendën e ndryshuar në përputhje me nenin 14 dhe mund të ndryshojë vendimin zbatues të përmendur në nenin 15(1) pa vonesa të panevojshme.
4. Në një ndryshim, Komisioni mund të pranojë afatet kohore për kushtet e pagesës që shtrihen deri në vitin 2028. Kjo nuk ndikon në afatin përfundimtar të përcaktuar në nenin 21(8).

Neni 17

Marrëveshja e huasë, operacionet e huamarrjes dhe huadhënies

1. Për të financuar mbështetjen në kuadër të Mekanizmit në formën e huave, Komisioni do të autorizohet, në emër të Unionit, të marrë hua fondet e nevojshme në tregjet e kapitalit ose nga institucionet financiare në përputhje me nenin 220a të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.
2. Me përjashtim të nenit 220(4) të Rregullores Financiare, disbursimet e huasë mund të zbatohen nëpërmjet WBIF në emër të Përfituesit. Shumat e rikuperuara do t'i transferohen përfituesit.
3. Komisioni do të lidhë një marrëveshje kredie me Përfituesin. Marrëveshja e kredisë do të përcaktojë shumën maksimale të kredisë, periudhën e disponueshmërisë dhe kushtet e detajuara të mbështetjes në kuadër të Mekanizmit në formën e kredive. Kreditë do të kenë kohëzgjatje maksimale prej 40 vitesh nga nënshkrimi i marrëveshjes së huasë.
Përveç dhe përmes përjashtimit të nenit 220(5) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, marrëveshja e huasë do të përmbajë shumën e parafinancimit dhe rregullat për shlyerjen e parafinancimit.
Në lidhje me shumat e kredisë të zbatuara nëpërmjet WBIF, marrëveshja e huasë gjithashtu:
 - (a) parashikon që Përfituesi autorizon në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar Komisionin që t'i paguajë disbursimet entitetit që zbaton fondin sipas kërkesës së atij entiteti dhe që Komisioni lirohet nga detyrimet e tij të pagesës ndaj Përfituesit duke i bërë pagesën atij entiteti;
 - (b) parashikon detyrimin e Përfituesit për të përballuar kostot e zbatimit dhe çdo tarifë që duhet lidhur me zbatimin e fondit në përputhje me kushtet e rënë dakord ndërmjet Komisionit dhe entitetit që zbaton fondin.

Neni 18
Provizionimi

1. Në bazë të nenit 211(1) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 provizionimi për kreditë sipas kësaj Rregulloreje do të krijohet në masën 9% pas vënies në dispozicion të çdo fondi që bie në nenin 6(3) të kësaj rregulloreje. Provizionimi do të përbëhet nga zarfi i përmendur në nenin 6(2) pika (a).

Zotimet buxhetore për provizionimin do të bëhen deri më 31 dhjetor 2027. Me përjashtim të nenit 211(2), fjalia e fundit e Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, provizionimi do të paguhet në mënyrë progresive dhe të konstituuar plotësisht më së voni kur huat të jenë disbursuar plotësisht.
2. Provizionimi do t'i paguhet fondit të përbashkët të provizionimit. Ai gjithashtu mund të mbulojë huatë për asistencë makrofinanciare në përputhje me nenin 31(5) të Rregullores (BE) 2021/947. Norma e provizionimit do të rishikohet të paktën çdo tre vjet nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
3. Komisioni autorizohet të miratojë një akt të deleguar në përputhje me nenin 26 për të ndryshuar normën e provizionimit duke zbatuar kriteret e përcaktuara në nenin 211(2) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.

Neni 19

Zbatimi i projekteve dhe programeve investive në kuadër të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor

1. Për të përfituar nga leva e mbështetjes financiare të BE-së për të tërhequr investime shtesë, investimet në infrastrukturë që mbështesin Agjendat e Reformës do të zbatohen nëpërmjet WBIF.
2. Vendimi zbatues i Komisionit i përmendur në nenin 15 do të parasheh shumën e fondeve që do të vihen në dispozicion për përdorim sipas WBIF.
3. Komisioni do të paraqesë propozimet përkatëse të projektit ose programit të investimeve për opinionin e Bordit Operativ të WBIF të përmendur në nenin 35(8) të Rregullores (BE) 2021/947 pas miratimit të vendimit të përmendur në nenin 21(3).
4. Të paktën 37% e mbështetjes financiare të pakthyeshme e kanalizuar përmes WBIF duhet t'i përgjigjet objektivave të klimës.
5. Financimi në kuadër të Mekanizmit të siguar nga zarfi financiar i referuar në nenin 6(2) pika (a), pas zbritjes së shumës së provizionimit, do të zbatohet në menaxhimin indirekt duke marrë parasysh një linjë investimesh dhe do të sigurohet gradualisht nëpërmjet kontributeve të paguara në fondin e përbashkët të krijuar në kuadër të WBIF për marrjen e kontributeve të donatorëve.
6. Ky financim nuk do t'i vihet në dispozicion për investime fondit të mbështetur nga fondi i përbashkët derisa të miratohet vendimi i përmendur në nenin 21(3).
7. Financimi në kuadër të Mekanizmit të ofruar nga huatë e përmendura në nenin 6(5), do të vihet në dispozicion nëpërmjet WBIF sipas marrëveshjes së kredisë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesve në përputhje me Nenin 17(2). Të kombinuara për të gjitha marrëveshjet e huasë, do të ketë maksimumi dymbëdhjetë kërkesa për disbursime në vit nga menaxherët e fondit të fondit të përbashkët të përmendur në nenin 12(2) drejtuar Komisionit. Projektet dhe programet e investimeve mund të marrin mbështetje nga dy burime financimi të përmendura në paragrafin 1, si dhe nga programe dhe

instrumente të tjera të Unionit, me kusht që një mbështetje e tillë nga burime, programe dhe instrumente të ndryshme parashikon shtesë dhe nuk mbulon të njëjtën kosto.

*Neni 20
Parafinancimi*

1. Pas dorëzimit të Agjendës së Reformës në Komision, Përfituesi mund të kërkojë lirim të një parafinancimi deri në 7% të shumës totale të parashikuar në këtë mekanizëm në përputhje me Nenin 6(4).
2. Komisioni mund të lirojë parafinancimin e kërkuar pas miratimit të vendimit të tij zbatues të përmendur në nenin 15 dhe hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Mekanizmit dhe të Marrëveshjes së Huasë të përmendur. Fondet do të lirohen në përputhje me nenin 21(3) fjalía e parë, dhe me kusht që të respektohen parakushtet e përcaktuara në nenin 5.
3. Komisioni vendos për afatin kohor për disbursimin e parafinancimit, i cili mund të disbursohet në një ose më shumë pjesë.

Neni 21

Vlerësimi i përmbushjes së kushteve të pagesës, mbajtja në burim, pakësimi dhe rishpërndarja e fondeve, rregullat për pagesat

1. Dy herë në vit, Përfituesi duhet të paraqesë një kërkesë të arsyetuar siç duhet për lirim të fondeve në lidhje me kushtet e përmbushjes së pagesës në lidhje me hapat sasiorë dhe cilësorë.
2. Komisioni vlerëson pa vonesa të panevojshme nëse Përfituesi ka arritur përmbushje të kënaqshme të kushteve të pagesës të përcaktuara në vendimin zbatues të Komisionit të përmendur në nenin 15(1). Përmbushja e kënaqshme e këtyre kushteve të pagesës do të presupozojë që masat që lidhen me të njëjtat reforma për të cilat Përfituesi kishte arritur përmbushje të kënaqshme në vendimet e mëparshme nuk janë kthyer mbrapa nga Përfituesi. Komisioni mund të ndihmohet nga ekspertë.
3. Kur Komisioni bën një vlerësim pozitiv të përmbushjes së kënaqshme të të gjitha kushteve të zbatueshme, ai do të miratojë pa vonesë të panevojshme një vendim që autorizon lirim të fondeve që korrespondojnë me këto kushte. Ky vendim, në përputhje me ndarjen e vendosur në nenin 6(4), përcakton shumën e fondeve që do të vihen në dispozicion si ndihmë financiare, e kanalizuar drejtpërdrejt në buxhetin kombëtar dhe shumën që do të vihet në dispozicion nëpërmjet WBIF. Në lidhje me këto shuma, vendimi do të përbëjë kushtin e përmendur në nenin 12 për shumën e fondeve që do të vihen në dispozicion si ndihmë financiare e kanalizuar drejtpërdrejt në buxhetin kombëtar dhe vlerësimin paraprak të përmendur në nenin 12 për shumën që do të vihet në dispozicion përmes WBIF.
4. Kur Komisioni bën një vlerësim negativ të përmbushjes së ndonjë kushti sipas kalendarit indikativ, lirimi i fondeve që korrespondojnë me këto kushte do të mbahet në burim. Shumat e mbajtura në burim mund të lirohen vetëm kur Përfituesi justifikon siç duhet, si pjesë e kërkesës së mëvonshme për lirim të fondeve, se ka marrë masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kënaqshme të kushteve përkatëse.
5. Kur Komisioni arrin në përfundimin se Përfituesi nuk ka marrë masat e nevojshme brenda një periudhe prej 12 muajsh nga vlerësimi fillestar negativ i përmendur në paragrafin 6, Komisioni do të zvogëlojë shumën e mbështetjes financiare të

pakthyeshme dhe të huasë në mënyrë proporcionale me pjesë që korrespondon me kushtet përkatëse të pagesës. Gjatë vitit të parë të zbatimit, do të zbatohet një afat prej 24 muajsh, i llogaritur nga vlerësimi fillestar negativ i përmendur në paragrafin 6. Përfituesi mund të paraqesë vëzhgimet e tij brenda dy muajve nga komunikimi ndaj tij i konkluzioneve të Komisionit.

6. Çdo shumë që korrespondon me kushtet e pagesës që nuk janë përmbushur deri më 31 dhjetor 2028 nuk do t'u lirohet Përfituesve dhe do t'u hiqet zotimi, ose do të anulohet nga shuma e disponueshme e mbështetjes së huasë, sipas rastit.
7. Komisioni mund të zvogëlojë shumën e mbështetjes financiare të pakthyeshme, duke përfshirë kompensimin në përputhje me nenin 102 të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, ose të kredisë, në rast të rasteve të identifikuar ose shqetësimeve serioze në lidhje me parregullsitë, mashtrimet, korrupsionin dhe konfliktet e interesit që prekin interesat financiare të Unionit, të cilat nuk janë korrigjuar nga Përfituesi, ose një shkelje serioze e një detyrimi që rezulton nga Marrëveshjet e Mekanizmit ose nga Marrëveshjet e Kredisë, duke përfshirë në bazë të informacionit të dhënë nga OLAF.
8. Komisioni mund të vendosë të rishpërndajë çdo shumë të reduktuar në përputhje me paragrafin 6 ose 7 midis Përfituesve të tjerë të Mekanizmit duke amenduar vendimet zbatuese të përmendura në nenin 15(1).
9. Për pjesën e financimit të Mekanizmit të paguar si ndihmë financiare, të kanalizuar drejtpërdrejt në buxhetet kombëtare të Përfituesve, me përjashtim të nenit 116(2) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046, afati i pagesës siç referohet në nenin 116 (1) pika (a), e Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 do të fillojë të zbatohet nga data e komunikimit të vendimit që autorizon disbursimin tek Përfituesi, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.
10. Neni 116(5) i Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 nuk zbatohet për pagesat e bëra si ndihmë financiare, të kanalizuar drejtpërdrejt në buxhetet kombëtare të Përfituesve në përputhje me këtë nen dhe nenin 22 të kësaj rregulloreje.
11. Pagesa e fondeve sipas këtij mekanizmi do të bëhet subjekt i financimit të disponueshëm. Fondet do të paguhen me këste. Një këst mund të paguhet në një ose më shumë pjesë.
12. Shuma e vënë në dispozicion si ndihmë financiare, e kanalizuar drejtpërdrejt në buxhetin kombëtar, do të paguhet pas vendimit të përmendur në paragrafin 3 në përputhje me marrëveshjen e kredisë.
13. Pagesa e çdo shume të mbështetjes në formën e një kredie, qoftë e kanalizuar drejtpërdrejt në buxhetin kombëtar ose nëpërmjet WBIF, do t'i nënshtrohet paraqitjes nga Përfituesi i një kërkesë për pagesë në formën e përcaktuar në marrëveshjen e kredisë.
14. Shuma e vënë në dispozicion përmes WBIF do të paguhet pas vendimit të përmendur në paragrafin 3, pas kërkesës për pagesë të përmendur në paragrafin 13 dhe pas marrjes së një kërkesë pagese nga menaxherët e fondit të fondit të përbashkët të krijuar sipas WBIF për marrjen e kontributeve të donatorëve.

KAPITULLI IV

Mbrojtja e interesave financiare të Unionit

Neni 22

Mbrojtja e interesave financiare të Unionit

1. Në zbatimin e Mekanizmit, Komisioni dhe Përfituesit do të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur interesat financiare të Unionit, duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit dhe kushtet specifike në të cilat do të funksionojë Mekanizmi, parakushtet e përcaktuara në nenin 5(1) dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjet specifike të Mekanizmit, veçanërisht në lidhje me parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe parregullsisë. Çdo Përfitues do të angazhohet të përparojë drejt sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit efektiv dhe efikas dhe të sigurojë që shumat e paguara gabimisht ose të përdorura gabimisht mund të rikuperohen.
2. Marrëveshja e Mekanizmit do të parashikojë detyrimet e mëposhtme të Përfituesit:
 - (a) të kontrollojë rregullisht nëse financimi i ofruar është përdorur në përputhje me rregullat e zbatueshme, veçanërisht në lidhje me parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe parregullsisë;
 - (b) të marrë masat e duhura për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar mashtrimin, korrupsionin, konfliktet e interesit dhe parregullsitë që prekin interesat financiare të Unionit, për të shmangur financimin e dyfishtë dhe për të ndërmarrë veprime ligjore për të rikuperuar fondet që janë përvetësuar, përfshirë në lidhje me çdo masë për zbatimin e reformave dhe projekteve apo programeve të investimeve në kuadër të agjendave të reformës;
 - (c) për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, veçanërisht për kontrollet mbi përdorimin e fondeve në lidhje me zbatimin e reformave në agjendat e reformave, për të siguruar mbledhjen dhe qasjen në të dhëna të përshtatshme për persona dhe entitete që marrin fonde për zbatimin e masave të Agjendës së Reformës sipas kapitulli III;
 - (d) të autorizojë shprehimisht Komisionin, OLAF-in, Gjykatën e Auditorëve dhe, sipas rastit, EPPO-në për të ushtruar të drejtat e tyre siç parashikohet në nenin 129 të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046.
3. Marrëveshja e Mekanizmit jep edhe të drejtën e Komisionit për të reduktuar në mënyrë proporcionale mbështetjen e ofruar në kuadër të Mekanizmit dhe për të rikuperuar çdo shumë të shpenzuar për të arritur objektivat e Mekanizmit ose për të kërkuar shlyerjen e parakohshme të huasë, në rastet e parregullsisë, mashtrimeve, korrupsionit dhe konflikteve të interesit që prekin interesat financiare të Unionit që nuk janë korrigjuar nga Përfituesi, ose të një shkeljeje serioze të një detyrimi që rezulton nga marrëveshje të tilla. Kur vendos për shumën e rikuperimit dhe reduktimit, ose shumën që duhet të shlyhet para kohe, Komisioni do të respektojë parimin e proporcionalitetit dhe do të marrë parasysh seriozitetin e parregullsisë, mashtrimit, korrupsionit ose konfliktit të interesit që prekin interesat financiare të Unionit, ose për shkeljen e një detyrimi. Përfituesit do t'i jepet mundësia të paraqesë vëzhgimet e tij përpara se të bëhet reduktimi ose të kërkohet shlyerja e parakohshme.

4. Personat dhe entitetet që zbatojnë fondet në kuadër të Mekanizmit do të raportojnë pa vonesë çdo rast të dyshuar mashtrimi, korrupsioni, konflikti i interesit dhe parregullsitë që prekin interesat financiare të Unionit, Komisionit dhe OLAF-it.

Neni 23

Roli i sistemeve të brendshme kombëtare dhe Autoriteteve Kombëtare të Auditimit

1. Për pjesën e financimit të Mekanizmit të paguar si ndihmë financiare, të kanalizuar drejtpërdrejt në buxhetet kombëtare të Përfituesve, Komisioni do të mbështetet në sistemet ekzistuese dhe të përmirësuara të kontrollit të brendshëm të Përfituesve, duke përfshirë Autoritetet Kombëtare të Auditimit dhe, sipas rastit, Shërbimet Koordinuese Kundër Mashtrimit të çdo Përfituesi të krijuar në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit.

Agjendat e Reformës do të kenë prioritet në vitet e para të zbatimit të reformave në lidhje me kapitullin 32 të negociatave, veçanërisht për menaxhimin e financave publike dhe kontrollin e brendshëm, si dhe për luftën kundër mashtrimit, së bashku me kapitujt 23 dhe 24, veçanërisht kur bëhet fjalë për drejtësinë, korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe kapitullin 8, veçanërisht për kontrollin e ndihmës shtetërore.

2. Përfituesit duhet t'i raportojnë Komisionit çdo parregullsi, duke përfshirë mashtrimin, të cilat kanë qenë objekt i një konstatimi parësor administrativ ose gjyqësor, pa vonesë, dhe ta mbajnë Komisionin të informuar për ecurinë e çdo procedure administrative dhe ligjore në lidhje me parregullësi të tilla. Ky raportim do të bëhet me mjete elektronike, duke përdorur Sistemin e Menaxhimit të Parregullsive, të krijuar nga Komisioni.
3. Entitetet e përmendura në paragrafin 2 do të mbajnë dialog të rregullt me Gjykatën Evropiane të Auditorëve, OLAF-in dhe, sipas rastit, EPPO-në.
4. Komisioni mund të kryejë rishikime të detajuara të sistemeve të zbatimit të buxhetit kombëtar bazuar në një vlerësim të rrezikut dhe dialog me Autoritetet Kombëtare të Auditimit dhe të nxjerrë rekomandime për përmirësime në sisteme.
5. Komisioni mund të miratojë rekomandime për Përfituesin për të gjitha rastet kur sipas mendimit të tij autoritetet kompetente nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar mashtrimin, korrupsionin, konfliktin e interesit dhe parregullsitë që kanë ndikuar ose rrezikojnë seriozisht të ndikojnë në menaxhimin e shëndoshë financiar të shpenzimet e financuara nga Mekanizmi dhe në të gjitha rastet kur ai identifikon dobësi që ndikojnë në hartimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të vendosur nga autoritetet. Përfituesi përkatës do të zbatojë rekomandimet e tilla ose do të japë një arsytim se pse nuk e ka bërë këtë.

KAPITULLI V

Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi

Neni 24

Monitorimi dhe raportimi

1. Komisioni monitoron zbatimin e Mekanizmit dhe vlerëson arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 3. Monitorimi i zbatimit do të jetë i synuar dhe proporcional me

aktivitetet e kryera në kuadër të Mekanizmit. Treguesit e përmendur në nenin 13(2) pritet të kontribuojnë në monitorimin e Mekanizmit nga Komisioni.

2. Marrëveshja e Mekanizmit të përmendur në nenin 9 do të përcaktojë rregullat dhe modalitetet që Përfituesit t'i raportojnë Komisionit për qëllimet e paragrafit 1.
3. Komisioni do t'i sigurojë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport vjetor mbi progresin drejt arritjes së objektivave të kësaj rregulloreje.
4. Komisioni i jep raportin e përmendur në paragrafin 3 Komitetit të përmendur në nenin 27.

Neni 25

Vlerësimi i Mekanizmit

1. Pas 31 dhjetorit 2027, por më së voni deri më 31 dhjetor 2031, Komisioni do të kryejë vlerësimin *ex-post* të Rregullores. Ai vlerësim *ex-post* do të vlerësojë kontributin e Unionit për arritjen e objektivave të kësaj rregulloreje.
2. Ky vlerësim *ex-post* do të përdorë parimet e praktikave të mira të Komitetit të Asistencës për Zhvillim të OBZHE-së, duke kërkuar të konstatojë nëse objektivat janë përmbushur dhe të formulojë rekomandime me synimin për të përmirësuar veprimet e ardhshme.

Komisioni do të komunikojë gjetjet dhe përfundimet e këtij vlerësimi *ex-post* të shoqëruar nga vëzhgimet dhe përcjellja e tij, për Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Shtetet Anëtare. Ky vlerësim *ex-post* mund të diskutohet me kërkesë të Shteteve Anëtare. Rezultatet do të ushqehen me përgatitjen e programeve dhe veprimeve të ardhshme dhe shpërndarjen e burimeve. Ky vlerësim *ex-post* dhe përcjellja të vihen në dispozicion të publikut.

Komisioni, në masën e duhur, do të shoqërojë të gjitha palët përkatëse të interesit, duke përfshirë Përfituesit, partnerët socialë, organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet lokale në procesin e vlerësimit të financimit të Unionit të parashikuar sipas kësaj Rregulloreje, dhe, sipas rastit, mund të kërkojë të ndërmarrë vlerësime të përbashkëta me Shtetet Anëtare dhe partnerë të tjerë me përfshirje të ngushtë të Përfituesve.

KAPITULLI VI

Dispozitat përfundimtare

Neni 26

Ushtrimi i delegimit

1. Kompetenca për të miratuar akte të deleguara do t'i jepet Komisionit në varësi të kushteve të përcaktuara në këtë nen.
2. Kompetenca për miratimin e akteve të deleguara të përmendura në nenin 18 do t'i jepet Komisionit për një periudhë të pacaktuar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
3. Delegimet e kompetencave të përmendura në nenin 18 mund të revokohen në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli. Vendimi për revokimin i jep fund delegimit të kompetencave të përcaktuara në atë vendim. Ai do të hyjë në fuqi në ditën pas

publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian ose në një datë të mëvonshme të specifikuar aty. Ai nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e ndonjë akti të deleguar tashmë në fuqi.

4. Përpara miratimit të një akti të deleguar, Komisioni do të konsultohet me ekspertë të caktuar nga çdo Shtet Anëtar në përputhje me parimet e përcaktuara në Marrëveshjen Ndërinstitucionale për Ligjbërje më të Mirë të datës 13 prill 2016.
5. Sapo të miratojë një akt të deleguar, Komisioni ia njofton atë njëkohësisht Parlamentit Evropian dhe Këshillit.
6. Një akt i deleguar i miratuar në përputhje me nenin 18 do të hyjë në fuqi vetëm nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli brenda një periudhe prej një muaji nga njoftimi i atij akti në Parlamentin Evropian dhe Këshillin ose nëse, përpara pas skadimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar të dy Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë do të zgjatet me një muaj me iniciativën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.

Neni 27

Procedura e komitetit

1. Komisioni mund të ndihmohet nga një komitet. Ai komitet do të jetë komitet sipas kuptimit të Rregullores (BE) Nr. 182/2011.
2. Kur i referohet këtij paragrafi, zbatohet neni 5 i Rregullores (BE) Nr. 182/2011.

Neni 28

Informacion, komunikim dhe publicitet

1. Komisioni mund të angazhohet në aktivitete komunikimi për të siguruar dukshmërinë e financimit të Unionit për mbështetjen financiare të parashikuar në Agjendat e Reformës, duke përfshirë përmes aktiviteteve të përbashkëta të komunikimit me Përfituesit. Komisioni, sipas rastit, mund të sigurojë që mbështetja në kuadër të Mekanizmit të komunikohet dhe të njihet përmes një deklarate financimi.
2. Marrësit e fondeve të Unionit duhet të njohin origjinën dhe të sigurojnë dukshmërinë e financimit të Unionit, duke përfshirë, kur është e aplikueshme, duke shfaqur stemën e Unionit dhe një deklaratë të përshtatshme financimi që lexon 'e financuar nga Bashkimi Evropian', veçanërisht kur promovon veprimet dhe rezultatet e tyre, duke ofruar informacion të synuar koherent, efektiv dhe proporcional për audiencë të shumta, duke përfshirë median dhe publikun.
3. Komisioni do të zbatojë veprimet e informacionit dhe komunikimit në lidhje me Mekanizmin, me veprimet e ndërmarra në përputhje me Mekanizmin dhe me rezultatet e arritura. Burimet financiare të alokuara për Mekanizmin do të kontribuojnë gjithashtu në komunikimin korporativ të prioritetëve politike të Unionit, për aq sa ato lidhen me objektivat e përmendura në nenin 3.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas publikimit të saj në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Hartuar në Bruksel,

*Për Parlamentin Evropian
Presidenti*

*Për Këshillin
Presidenti*

PASQYRA FINANCIARE LEGJISLATIVE

1. KORNIZA E PROPOZIMIT/INICIATIVËS

1.1. Titulli i propozimit/iniciativës

Propozim për një Rregullore të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Mekanizmit së Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor

1.2. Fusha(t) e politikave në fjalë

Marrëdhëniet e BE-së me pjesën tjetër të botës

1.3. Propozimi/iniciativa ka të bëjë me:

veprim të ri

veprim të ri pas një projekti pilot/veprim përgatitor¹⁹

zgjerimi i një veprimi ekzistues

bashkim ose ridrejtim i një ose më shumë veprimeve drejt një tjetri/një veprimi të ri

1.4. Objektivi(at)

1.4.1. Objektivat e përgjithshme

Objektivat strategjike të Mekanizmit janë të përshpejtojnë konvergencën socio-ekonomike të ekonomive të Ballkanit Perëndimor me BE-në duke mbështetur reformat dhe investimet e synuara.

Mekanizmi duhet të mbështesë reformat dhe investimet që nxisin integrimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor me tregun e vetëm të BE-së dhe përmirësojnë integrimin ekonomik rajonal, reformat që lidhen me bazat e procesit të zgjerimit (përfshirë sundimin e ligjit, prokurimin publik, luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimin të organizuar), si dhe përafrimi i mëtejshëm me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së me synimin për anëtarësim në Union.

1.4.2. Objektivi specifik

Mekanizmi do të mbështesë masat për:

- përshpejtimin e tranzicionit të Përfituesve drejt ekonomive të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, të afta për t'i bërë ballë presioneve konkurruese të tregut të tregut të vetëm të Unionit dhe në një mjedis të qëndrueshëm investimi;
- nxitjen e integritit ekonomik rajonal në veçanti nëpërmjet progresit në krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal;
- nxitjen e integritit ekonomik të Përfituesve me tregun e vetëm të Unionit;
- mbështetjen për integrim ekonomik rajonal dhe integrim të zgjeruar me tregun e vetëm të BE-së përmes përmirësimit të lidhjes në rajon në përputhje me Rrjetet Trans evropiane;
- përshpejtimin e tranzicionit të gjelbër në përputhje me Agjendën e Gjelbër 2020 për Ballkanin Perëndimor dhe duke mbuluar të gjithë sektorët ekonomikë, veçanërisht

¹⁹ Siç përmendet në nenin 58(2)(a) ose (b) të Rregullores Financiare.

energjinë, duke përfshirë tranzicionin drejt ekonomisë së dekarbonizuar, neutrale ndaj klimës, resiliente ndaj klimës dhe ekonomisë qarkore;

- promovimin e transformimit digjital si një mundësi për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje gjithëpërfshirëse;

- nxitjen e inovacionit, veçanërisht për NVM-të dhe në mbështetje të tranzicionit të gjelbër dhe atij digjital;

- nxitjen e arsimit cilësor, trajnimit, rikualifikimit dhe ngritjes së shkathtësive dhe politikave të punësimit;

- forcimin e mëtejshëm të bazave të procesit të zgjerimit, duke përfshirë sundimin e ligjit, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, nëpërmjet promovimit të një gjyqësori të pavarur, sigurimit të përforcuar, luftës kundër mashtrimit, korrupsionit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, evazionit fiskal dhe mashtrimit fiskal; pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare; forcimin e lirisë së mediave dhe lirisë akademike dhe një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile; nxitjen e dialogut social; promovimin e barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe tolerancën, për të siguruar dhe forcuar respektimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave;

- përforcimin e efektivitetit të administratës publike dhe mbështetjen e transparencës, reformave strukturore dhe qeverisjes së mirë në të gjitha nivelet, duke përfshirë fushat e menaxhimit të financave publike dhe prokurimit publik dhe kontrollit të ndihmës shtetërore; mbështetjen e iniciativave dhe organeve të përfshira në mbështetjen dhe zbatimin e drejtësisë ndërkombëtare në Përfituesit e Ballkanit Perëndimor.

1.4.3. *Rezultati(et) dhe ndikimi i pritshëm*

Specifikoni efektet që duhet të ketë propozimi/iniciativa tek përfituesit/grupet e synuara.

Mbështetja në kuadër të Mekanizmit pritet t'u mundësojë Përfituesve të zbatojnë reformat dhe investimet e nevojshme për t'i bërë ekonomitë e tyre më konkurruese, duke rritur lidhjen e brendshme të rajonit dhe konvergencën me Unionin.

Zbatimi i Mekanizmit duhet gjithashtu të përforcojë kontrollin e brendshëm dhe sistemet e menaxhimit të financave publike tek Përfituesit, si dhe zbatimin e bazave të procesit të zgjerimit, veçanërisht lidhur me sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit të organizuar.

1.4.4. *Treguesit e performancës*

Specifikoni treguesit për monitorimin e progresit dhe arritjeve.

Treguesit specifikë do të përcaktohen në Agjendën e Reformës dhe marrëveshjet e huasë që do të lidhen me secilin Përfitues sipas neneve 12 dhe 17.

1.5. **Arsyet për propozimin/iniciativën**

1.5.1. *Kërkesat që duhet të plotësohen në afat të shkurtër ose afatgjatë, duke përfshirë një afat kohor të detajuar për shtrirjen e zbatimit të iniciativës*

Pavarësisht se Përfituesit janë në faza të ndryshme të rrugës së anëtarësimit në BE, prodhimi i tyre ekonomik dhe konkurrueshmëria ngelin prapa asaj të BE-së. Reformat dhe investimet e mbështetura nga ky mekanizëm supozohet të përshpejtojnë arritjen e konvergencës dhe përafrimit më të mirë me standardet e BE-së, si dhe integrimin më të ngushtë ekonomik brenda rajonit dhe me tregun e përbashkët të BE-së.

Parakushtet për të marrë financim nga Mekanizmi, janë që Përfituesit të mbështesin dhe respektojnë mekanizmat efektivë demokratikë, sundimin e ligjit dhe të garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Një tjetër parakusht duhet të jetë që Serbia dhe Kosova të angazhohen në mënyrë konstruktive në normalizimin e marrëdhënieve të tyre me synimin për të zbatuar plotësisht të gjitha detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Shtojca e Zbatimit të saj dhe të gjitha Marrëveshjet e Dialogut të kaluar dhe të angazhohen në negociata për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.

Komisioni do të verifikojë gjithashtu nëse janë plotësuar kushtet e përgjithshme (stabiliteti makro-financiar, menaxhimi i shëndoshë i financave publike, transparencja dhe mbikëqyrja e buxhetit).

Për të marrë financim, Përfituesve do t'u kërkohet të hartojnë Agjendat e Reformës, bazuar në strategjitë e tyre të rritjes, Programet e Reformës Ekonomike, metodologjinë e rishikuar të zgjerimit dhe raportet e zgjerimit, të cilat do të miratohen nga Komisioni nëpërmjet një vendimi zbatues. Agjendat do të përmbajnë një numër të kufizuar reformash dhe fushash investimi me kushtet e pagesës dhe shumat e bashkëlidhura me to. Këto kushte do të pasqyrojnë progresin në reformat specifike socio-ekonomike, duke përfshirë bazat e procesit të zgjerimit dhe sundimit të ligjit. Pas vendimit për miratimin e Agjendave të Reformës dhe përfundimit të Marrëveshjeve përkatëse, Përfituesit do të kenë të drejtë të marrin parafinancim.

Fondet në kuadër të Mekanizmit do të lirohen çdo gjashtë muaj pas paraqitjes nga Përfituesit e kërkesave që justifikojnë përmbushjen e kushteve të pagesës dhe konfirmojnë ligjshmërinë dhe rregullsinë e çdo transaksioni themelor, shoqëruar me një raport mbi përcjelljen e rasteve të keqmenaxhimit të financimit përkatës. Komisioni do të vërë në dispozicion fondet në bazë të vlerësimit të kërkesave. Fondet mund të lirohen si shuma të plota, shuma të reduktuara ose të mbahen plotësisht, në varësi të nivelit të përmbushjes së kushteve të pagesës, sipas llojit. Fondet e mbajtura në burim mund të rishpërndahen midis Përfituesve të tjerë në vitet në vijim.

Investimet e parashikuara në Agjendat e Reformës do të mbështeten nëpërmjet WBIF. Projektet ose programet e ndërlidhura do t'i paraqiten Bordit Operativ të WBIF-së për opinion vetëm pas vlerësimit të Komisionit për përmbushjen e kushteve përkatëse të pagesës dhe lirim të mëvonshëm të fondeve dhe do t'i nënshtrohen rregullave të thirrjes përkatëse të WBIF.

Në periudhën 2024-2027 priten katër cikle vjetore.

- 1.5.2. *Vlera e shtuar e përfshirjes së Unionit (ajo mund të rezultojë nga faktorë të ndryshëm, p.sh. fitimet e koordinimit, siguria ligjore, efektiviteti më i madh ose plotësimet). Për qëllimet e kësaj pike, "vlera e shtuar e përfshirjes së Unionit" është vlera që rezulton nga ndërhyrja e Unionit, e cila është shtesë e vlerës që do të ishte krijuar ndryshe vetëm nga Shtetet Anëtare.*

Veprimi në nivel të Unionit është i nevojshëm për të arritur një konvergencë të përsheptuar ekonomike të Ballkanit Perëndimor me BE-në në rrugën e tyre drejt anëtarësimit të mundshëm në Union. Madhësia e ndihmës së nevojshme është e tillë që rajoni vazhdon të kërkojë mbështetje të qëndrueshme të jashtme që asnjë Shtet Anëtar, apo donator i vetëm, nuk mund ta sigurojë i vetëm. Unioni është në një pozicion unik për të ofruar ndihmë të jashtme shumëvjeçare në rajon në kohën e duhur, të koordinuar dhe të parashikueshme. Unioni mund të shfrytëzojë gjithashtu

kapacitetin e tij huamarrës për t'u dhënë hua përfituesve në rajon me kushte të favorshme, si dhe për të ofruar grante në një perspektivë shumëvjeçare.

1.5.3. Mësimet e nxjerra nga përvoja të ngjashme në të kaluarën

Mekanizmi bazohet dhe plotëson ndihmën e ofruar për Ballkanin Perëndimor sipas Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III), si dhe përdor një nga mekanizmat e tij të suksesshëm – Kornizën e Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Të dyja këto instrumente kanë vërtetuar se financimi i BE-së mund të ofrojë një levë të konsiderueshme kur përdoret së bashku me financimin nga donatorë të tjerë në kontekste të kombinuara. Megjithatë, formati i këtij mekanizmi është i ndryshëm në atë që mbështetet kryesisht në kreditë koncesionare të marra nga Unioni falë rejtingut të shkëlqyer të kredisë. Mekanizmi do të bazohet në mësimet e nxjerra nga Mekanizmi e Rikuperimit dhe Resiliencës, e cila u krijua në vitin 2020, si dhe nga një Mekanizëm për Ukrainën e propozuar së fundmi.

1.5.4. Pajtueshmëria me Kornizën Financiare Shumëvjeçare dhe sinergjitë e mundshme me instrumente të tjera të përshtatshme

Mekanizmi e propozuar synon pajisjen e Unionit me një instrument ligjor i cili do ta lejojë atë të mbështesë një konvergjençë më të madhe socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Union. Mekanizmi do të jetë plotësuese e asistencës në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit, i cili fokusohet në përafrimin e Përfituesve me *acquis* të BE-së dhe përgatitjen për marrjen e detyrimeve të anëtarësimit.

Ky propozim i ri legjislativ për Mekanizmin për Reforma dhe Rritje Ekonomike plotëson propozimin për një Rregullore të Këshillit COM(2023)337, që ndryshon Rregulloren 2020/2093 që përcakton kuadrin financiar shumëvjeçar (MFF) për vitet 2021 deri në 2027 (shih seksionet 1.5.5 dhe 3.2.4).

Shuma e përgjithshme e Mekanizmit do të sigurohet përmes kredive dhe mbështetjes së pakthyeshme. Komponenti i huasë do të arrijë një maksimum prej 4 miliardë eurosh për të gjithë Përfituesit gjatë gjithë periudhës 2024-2027. Huatë do të garantohen nëpërmjet Fondit të Përbashkët të Provizionimit në normën 9%. Shuma shtesë e granteve në formën e mbështetjes së pakthyeshme e paraparë në propozimin për një MFF të rishikuar është 2 miliardë euro, duke përfshirë provizionimin dhe shpenzimet administrative.

1.5.5. Vlerësimi i opsioneve të ndryshme të disponueshme të financimit, duke përfshirë hapësirën për rishpërndarje

Buxheti i Unionit tashmë po ofron mbështetje për përgatitjen për anëtarësimin e mundshëm në BE përmes Instrumentit të Ndihmës së Para-Aderimit (IPA III), i cili mbulon Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, dhe bazohet në grante, garanci të kombinuara dhe buxhetore. Ky financim i caktohet plotësisht aktiviteteve të nevojshme që lidhen me shtrirjen dhe përgatitjet lidhur me zgjerimin, si dhe për zbatimin e Planit Ekonomik dhe të Investimeve.

Objektivat e Mekanizmit të propozuar përsheptuan konvergjençën socio-ekonomike vetëm në Ballkanin Perëndimor dhe bazohen në një qasje të ndryshme, duke vendosur një lidhje të fortë midis përmbylljes së angazhimeve të reformës dhe qasjes në financim. Ai bazohet gjithashtu në një skemë tjetër financimi, ku 2/3 e financimit vijnë nga kreditë e marra nga Unioni dhe të transferuara tek përfituesit.

Për të siguruar zbatimin e qetë dhe transparent të çdo investimi të identifikuar sipas Agjendave të Reformës së përfituesve, Komisioni synon të përdorë metodologjinë e testuar të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor, duke ruajtur kushtëzimet e përmendura më sipër.

Duke qenë se ky është një mekanizëm krejtësisht i ndryshëm ndihme, që synon një grup specifik prioritetesh në rajon, dhe se objektivat e IPA kërkojnë të gjithë financimin e parashikuar për të në buxhet, përdorimi i instrumentit ekzistues (IPA III) nuk do të ishte praktik, ndërkohë që rishpërndarja e fondeve brenda këtij instrumenti nuk do të ishte e realizueshme.

1.6. Kohëzgjatja dhe ndikimi financiar i propozimit/iniciativës

kohëzgjatje e kufizuar

- në fuqi nga [DD/MM]VVVV deri në [DD/MM]VVVV
- Ndikimi financiar nga viti 2024 deri në 2027 për mjetet e zotimeve dhe nga viti 2024 për mjetet e pagesave.

kohëzgjatje e pakufizuar

- Zbatimi me një periudhë fillestare nga viti VVVV deri në VVVV,
- e ndjekur nga funksionimi në shkallë të plotë.

1.7. Metoda(t) e zbatimit të buxhetit të planifikuar²⁰

Menaxhimi direkt nga Komisioni

- nga departamentet e tij, duke përfshirë stafin e tij në delegacionet e Unionit;
- nga agjencitë ekzekutive

Menaxhimi i përbashkët me shtetet anëtare

Menaxhimi indirekt duke ia besuar detyrat e zbatimit të buxhetit:

- vendeve të treta ose organeve që ata kanë caktuar;
- organizatave ndërkombëtare dhe agjencive të tyre (të specifikohen);
- EIB dhe Fondit Evropian të Investimeve;
- organeve të referuara në nenet 70 dhe 71 të Rregullores Financiare;
- organet e së drejtës publike;
- organet e rregulluara nga e drejta private me mision shërbimi publik deri në masën që u sigurohen garancitë e duhura financiare;
- organet e rregulluara nga e drejta private e një Shteti Anëtar, të cilëve u është besuar zbatimi i një partneriteti publik-privat dhe që u sigurohen garancitë e duhura financiare;
- organet ose personat të cilëve u është besuar zbatimi i veprimeve specifike në CFSP në përputhje me Titullin V të TEU-së dhe të identifikuar në aktin bazë përkatës.
- Nëse tregohet më shumë se një mënyrë menaxhimi, jepni detaje në seksionin "Komente".

²⁰ Detajet e metodave të zbatimit të buxhetit dhe referencat për Rregulloren Financiare mund të gjenden në faqen BUDGpedia: <https://myintracomm.ec.europa.eu/corp/budget/financial-rules/budget-implementation/Pages/implementation-methods.aspx>

Neni 8 detajon format e zbatimit të Mekanizmit, pra menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në përputhje me Rregulloren Financiare.

2. MASAT E MENAXHIMIT

2.1. Rregullat e monitorimit dhe raportimit

Specifikoni shpeshësinë dhe kushtet.

Hapat specifike sasiorë dhe cilësorë do të përcaktohen në Agjendat e Reformës (miratuar nga Komisioni në një vendim zbatues), në mënyrë që të monitorohet plotësimi i kushteve të pagesës. Përfituesi do të paraqesë një kërkesë gjashtëmujore të justifikuar siç duhet për lirim të mbështetjes financiare të pakthyeshme dhe të kredisë, duke përcaktuar se si është arritur përmbushja e kënaqshme e këtyre kushteve, bazuar në treguesit e identifikuar në vendimin zbatues.

Përveç kësaj, Agjendat e Reformës do të përcaktojnë tregues monitorimi që duhet të lejojnë monitorimin dhe raportimin e progresit të Përfituesve mbi objektivat e përgjithshme dhe specifike të Mekanizmit më gjerësisht.

Komisioni do t'i raportojë çdo vit Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komitetit të përmendur në nenin 27 mbi zbatimin e fondeve të ofruara në kuadër të Mekanizmit, si dhe progresin drejt objektiveve.

Komisioni do të kryejë gjithashtu një vlerësim *ex-post* të Rregullores.

2.2. Sistemi(et) e menaxhimit dhe kontrollit

2.2.1. Arsyetimi i mënyrave të menaxhimit, mekanizmave të zbatimit të financimit, modaliteteve të pagesës dhe strategjisë së kontrollit të propozuar

Mekanizmi do të zbatohet nën menaxhim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Një pjesë do të jetë menaxhimi i drejtpërdrejtë me transferim të drejtpërdrejtë të fondeve në buxhetin e shtetit të Përfituesit, ndërsa investimet specifike do të kanalizohen përmes WBIF, pra menaxhimi indirekt me IFI-të.

Strategjia e kontrollit do t'i përshtatet zbatimit në secilën prej këtyre shtyllave duke përdorur monitorimin, vlerësimin dhe auditimet. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zbatimit nga Përfituesit e fondeve të vëna në dispozicion të tyre. Lirimi i fondeve do të bëhet sipas një plani fiks gjashtëmujor, në bazë të kërkesave të paraqitura nga përfituesit dhe pas verifikimit nga Komisioni për plotësimin e kushteve përkatëse të pagesës.

Struktura shumështrësore e mekanizmave të kontrollit në fuqi (shih edhe seksionin 2.3) ofron një kuadër të integruar për të siguruar që të gjitha masat e duhura për të mbrojtur interesat financiare të Unionit janë në fuqi. Ai do të garantojë që të merret parasysh parimi i proporcionalitetit dhe kushtet specifike në të cilat do të funksionojë Mekanizmi.

2.2.2. Informacion në lidhje me rreziqet e identifikuar dhe sistemin(et) e kontrollit të brendshëm të ngritur për t'i zbutur ato

Rreziku kryesor i identifikuar në lidhje me financimin lidhet me mospërmbushjen e kushteve të pagesës që lidhen me disbursimin e financimit.

Masat që do të ndërmerren për të zbutur këtë rrezik janë si më poshtë:

-vlerësimi nga Komisioni për plotësimin e kushteve përkatëse të pagesës përpara disbursimit të fondeve, me mundësi mbajtjeje në burim të fondeve;

-reduktimi ose mbajtja në burim e mbështetjes së dhënë, ose rikuperimin e çdo shume të shpenzuar për arritjen e objektivave të Mekanizmit, në rastet e parregullsisve, mashtrimeve, korrupsionit dhe konflikteve të interesit që prekin interesat financiare të Unionit, të cilat nuk janë korrigjuar nga Përfituesi; ose të një shkeljeje të rëndë të një detyrimi që rezulton nga marrëveshjet e lidhura me Përfituesit;

-pezullimi i financimit në rast se Përfituesi përkatës nuk përmbush parakushtet e përcaktuara në nenin 5.

- 2.2.3. *Vlerësimi dhe justifikimi i efektivitetit të kostos së kontrolleve (raporti i "kostove të kontrollit ÷ vlera e fondeve përkatëse të menaxhuara"), dhe vlerësimi i niveleve të pritshme të rrezikut të gabimit (në pagesë dhe në mbyllje)*

Kontributi financiar do t'u jepet përfituesve në formën e financimit që nuk lidhet me koston e përmendur në pikën (a) të nenit 125(1) të Rregullores Financiare.

2.3. Masat për të parandaluar mashtrimet dhe parregullsitë

Specifikojnë masat ekzistuese ose të parashikuara parandaluese dhe mbrojtëse, p.sh. nga Strategjia Kundër Mashtrimit.

Propozimi përmban dispozita specifike për mbrojtjen e interesave financiare të Unionit. Mekanizmi do të pajiset me një sistem të fortë auditimi dhe kontrollesh të përcaktuara në një mekanizëm shumështrësor: reforma e sistemeve të auditimit dhe kontrollit të Përfituesve do të përfshihet si pjesë e reformave në kuadër të Agjendave të Reformës; përveç kësaj, Komisioni mund të kryejë rishikime të detajuara të sistemeve të zbatimit të buxhetit kombëtar bazuar në një vlerësim të rrezikut dhe dialog me Autoritetet Kombëtare të Auditimit, dhe të nxjerrë rekomandime për përmirësime në sisteme. Për më tepër, në përputhje me Rregulloren (BE, Euratom) 2018/1046, OLAF, Gjykata e Auditorëve dhe Zyra e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) do të kenë të drejtat dhe qasjen e nevojshme për të kryer rolet e tyre përkatëse.

Pjesa investuese e Mekanizmit do të zbatohet përmes menaxhimit indirekt me institucionet financiare ndërkombëtare bazuar në vlerësimet e shtyllave dhe marrëveshjet kornizë me to.

3. NDIKIMI FINANCIAR I PËRLLOGARITUR I PROPOZIMIT/INICIATIVËS

3.1. Korniza financiare shumëvjeçare - linja(t) buxhetore të shpenzimeve të prekura

– Kërkohen linja të reja buxhetore

| Mbi tavanet e MFF | Linja buxhetore | Lloji i shpenzimeve | Kontributi | | | |
|-------------------|--|---------------------|---------------------|--|-----------------------------|---------------------------------|
| | Numri | Ndryshe/Jo-ndryshe | nga vendet e EFTA-s | nga vendet kandidatë dhe kandidatët potencialë | nga vende të tjera të treta | të ardhura të tjera të caktuara |
| Kreu 6 | 15.0301 – Mekanizmi për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor – Shpenzimet operative | DA | PO | p.m. | PO | PO |
| Kreu 6 | 15.0302 – Mekanizmi për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor – Provizionimi i Fondit të Përbashkët të Sigurimit | DA | PO | p.m. | PO | PO |
| Kreu 6 | 15.010102 – shpenzime mbështetëse për Mekanizmin për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor | DA | PO | p.m. | PO | PO |

3.2. Ndikimi financiar i përlogaritur i propozimit për mjetet

3.2.1. Përmbledhje e ndikimit të vlerësuar për mjetet operative

- Propozimi/iniciativa nuk kërkon përdorimin e mjeteve operative
- Propozimi/iniciativa kërkon përdorimin e mjeteve operative, siç shpjegohet më poshtë:

| Mekanizmi për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor - financim* (milion euro) | | | | | |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Lloji i mbështetjes | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 | Total |
| Të pakthyeshme (Grante) | 500 | 500 | 500 | 500 | 2 000 |
| <i>nga të cilat shpenzime administrative</i> | 7.5 | 7.5 | 7.5 | 7.5 | 30 |
| Kredi | 1 000 | 1 000 | 1 000 | 1 000 | 4 000 |
| TOTAL ** | 1 500 | 1 500 | 1 500 | 1 500 | 6 000 |

* Shpërndarja vjetore dhe e përgjithshme e mbështetjes dhe kredive të pakthyeshme është thjesht tregues dhe vetëm për qëllime ilustruese. Shpërndarja e vërtetë do t'i nënshtrohet vendimmarrjes vjetore

** Tabela supozon mjetet e zotimeve të barabarta me mjetet e pagesave. Kjo është thjesht për qëllime ilustruese. Kalibrimi i vërtetë të dyjave do të vlerësohet në bazë të nevojave vjetore.

3.2.2 Përmbledhje e ndikimit të vlerësuar në mjetet operative (milion euro)

| | Viti 2024 ²¹ | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | GJITHSEJ |
|--|-------------------------|-----------|-----------|-----------|----------|
| KREU 6 i kornizës financiare shumëvjeçare | | | | | |
| 15.0301 – Mekanizmi për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor – Shpenzimet operative | 402.55 | 402.55 | 402.55 | 402.55 | 1 610.2 |
| 15.0302 – Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor – Provizionimi i Fondit të Përbashkët të Sigurimit | 90 | 90 | 90 | 90 | 360 |
| Nën-totali KREU 6 i kornizës financiare shumëvjeçare | 492.55 | 492.55 | 492.55 | 492.55 | 1 970.2 |

3.2.3. Përmbledhje e ndikimit të vlerësuar në mjetet administrative

- Propozimi/iniciativa nuk kërkon përdorimin e mjeteve të natyrës administrative
- Propozimi/iniciativa kërkon përdorimin e mjeteve të natyrës administrative, siç shpjegohet më poshtë:

Milion euro (deri në tri shifra dhjetore)

| | Viti 2024 ²² | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | GJITHSEJ |
|--|-------------------------|-----------|-----------|-----------|----------|
|--|-------------------------|-----------|-----------|-----------|----------|

| | | | | | |
|---|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| KREU 7 i kornizës financiare shumëvjeçare | | | | | |
| Burimet njerëzore | 1.026 | 1.026 | 1.026 | 1.026 | 4.104 |
| Shpenzime të tjera administrative | 0.030 | 0.030 | 0.030 | 0.030 | 0.120 |
| Nën-totali KREU 7 i kornizës financiare shumëvjeçare | 1.056 | 1.056 | 1.056 | 1.056 | 4.224 |

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| Jashtë KREU 7²³ i kornizës financiare shumëvjeçare | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|

²¹ Viti 2024 është viti në të cilin fillon zbatimi i propozimit/iniciativës.

²² Viti 2024 është viti në të cilin fillon zbatimi i propozimit/iniciativës.

²³ Asistencë dhe shpenzime teknike dhe/ose administrative në mbështetje të zbatimit të programeve dhe/ose veprimeve të BE-së (ish linjat 'BA'), kërkime indirekte, kërkime të drejtpërdrejta.

| | | | | | |
|---|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|
| | | | | | |
| Burimet njerëzore | 2.529 | 2.529 | 2.529 | 2.529 | 10.116 |
| Shpenzime të tjera të natyrës administrative | 4.920 | 4.920 | 4.920 | 4.920 | 19.680 |
| Nën-totali jashtë KRERËVE 1-7 i kornizës financiare shumëvjeçare | 7.449 | 7.449 | 7.449 | 7.449 | 29.796 |

| | | | | | |
|-----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|
| GJITHSEJ | 8.505 | 8.505 | 8.505 | 8.505 | 34.020 |
|-----------------|--------------|--------------|--------------|--------------|---------------|

Mjetet e nevojshme për burimet njerëzore dhe shpenzimet e tjera të një natyre administrative do të plotësohen nga mjetet prej DG që tashmë janë caktuar për menaxhimin e veprimit dhe/ose janë rishpërndarë brenda DG-së, së bashku nëse është e nevojshme me çdo alokim shtesë që mund t'i jepet DG-së menaxhuese sipas procedurës vjetore të alokimit dhe në dritën e kufizimeve buxhetore.

3.2.3.1. Kërkesat e vlerësuara të burimeve njerëzore

- Propozimi/iniciativa nuk kërkon përdorimin e burimeve njerëzore
- Propozimi/iniciativa kërkon përdorimin e burimeve njerëzore, siç shpjegohet më poshtë:

Vlerësimi të shprehet në njësi ekuivalente me orar të plotë

| | Viti 2024 | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | |
|---|----------------------|-----------|-----------|-----------|---|
| ○ Postet e planit të institucionit (zyrtarë dhe personel të përkohshëm) | | | | | |
| 20 01 02 01 (Selia dhe Zyrat e Përfaqësimit të Komisionit) | 6 | 6 | 6 | 6 | |
| 20 01 02 03 (Delegacionet) | | | | | |
| 01 01 01 01 (Kërkim indirekt) | | | | | |
| 01 01 01 11 (Kërkim indirekt) | | | | | |
| Linjat e tjera buxhetore (specifikoni) | | | | | |
| ○ Stafi i jashtëm (në njësinë ekuivalente me orar të plotë: FTE)²⁴ | | | | | |
| 20 02 01 (AC, END, INT nga 'zarfi global') | | | | | |
| 20 02 03 (AC, AL, END, INT dhe JPD në delegacione) | | | | | |
| 15.010102 – shpenzime mbështetëse për Mekanizmin për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor | - në selinë qendrore | 9 | 9 | 9 | 9 |
| | - në Delegacione | 9 | 9 | 9 | 9 |
| Linjat e tjera buxhetore (specifikoni) | | | | | |
| GJITHSEJ | 24 | 24 | 24 | 24 | |

Mjetet e nevojshme për burimet njerëzore dhe shpenzimet e tjera të një natyre administrative do të plotësohen nga mjetet prej DG që tashmë janë caktuar për menaxhimin e veprimit dhe/ose janë rishpërndarë brenda DG-së, së bashku nëse është e nevojshme me çdo alokim shtesë që mund t'i jepet DG-së menaxhuese sipas procedurës vjetore të alokimit dhe në dritën e kufizimeve buxhetore.

Përshkrimi i detyrave që do të kryhen:

| | |
|------------------------------------|---|
| Zyrtarë dhe personel të përkohshëm | FTE-të e kërkuara do të punojnë në zhvillimin e politikave, çështjet ligjore, me fokus të veçantë në çështjet e prokurimit, menaxhimin financiar, menaxhimin e kontratave, auditimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin. |
| Stafi i jashtëm | FTE-të e kërkuara do të punojnë në zhvillimin e politikave, çështjet ligjore, me fokus të veçantë në çështjet e prokurimit, menaxhimin financiar, menaxhimin e kontratave, auditimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin. |

²⁴ AC= Staf i me kontratë; AL = Staf i lokal; END= Ekspert kombëtar i dërguar; INT = stafi i agjencisë; JPD= Profesionistë juniorë në delegacione.

3.2.4. Pajtueshmëria me kornizën aktual financiar shumëvjeçar

Propozimi/iniciativa:

- mund të financohet plotësisht nëpërmjet rishpërndarjes brenda kreut përkatës të Kornizës Financiare Shumëvjeçare (MFF).

Shpjegoni se çfarë riprogramimi kërkohet, duke specifikuar linjat buxhetore në fjalë dhe shumat përkatëse. Ju lutemi jepni një tabelë në formatin Excel në rastin e riprogramimit të madh.

- kërkon përdorimin e marzhit të paalokuar nën kreun përkatës të MFF-së dhe/ose përdorimin e instrumenteve të veçanta siç përcaktohet në Rregulloren për MFF.

Shpjegoni se çfarë kërkohet, duke specifikuar krerët dhe linjat buxhetore në fjalë, shumat përkatëse dhe instrumentet e propozuara për t'u përdorur.

- kërkon një rishikim të MFF.

Ky propozim i ri legjislativ për Mekanizmin për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor vjen paralelisht me propozimin për një Rregullore të Këshillit COM(2023)337, që ndryshon Rregulloren 2020/2093 që përcakton kuadrin financiar shumëvjeçar (MFF) për vitet 2021 deri në 2027. Amendamenti i kësaj Rregulloreje është i nevojshëm për të rritur Kreun 6 për 2024-2027 për të ofruar financim për këtë mekanizëm si mbështetje e pakthyeshme dhe provizionim për mbështetjen në formën e kredive.

3.2.5. Kontributet e palës së tretë

Propozimi/iniciativa:

- nuk parashikon bashkëfinancim nga palë të treta
- parashikon bashkëfinancimin nga palët e treta të vlerësuara më poshtë:

Mjetet në milion euro (deri në tri shifra dhjetore)

3.3. Ndikimi i vlerësuar në të ardhura

- Propozimi/iniciativa nuk ka ndikim financiar në të ardhurat.
- Propozimi/iniciativa ka ndikimin financiar të mëposhtëm:
 - për burimet e veta
 - për të ardhura të tjera
 - ju lutemi tregoni nëse të ardhurat i janë caktuar linjave të shpenzimeve

Milion euro (deri në tri shifra dhjetore)

| Linja e të ardhurave buxhetore: | Mjetet e disponueshme për vitin aktual financiar | Ndikimi i propozimit/iniciativës ²⁵ | | | | | | | |
|---------------------------------|--|--|----------|----------|----------|---|------|------|------|
| | | Viti N | Viti N+1 | Viti N+2 | Viti N+3 | Shkruani aq vite sa të jetë e nevojshme për të treguar kohëzgjatjen e ndikimit (shih pikën 1.6) | | | |
| Neni | | p.m. | p.m. | p.m. | p.m. | p.m. | p.m. | p.m. | p.m. |

²⁵

Për sa i përket burimeve të veta tradicionale (taksat doganore, taksat e sheqerit), shumat e treguara duhet të jenë shuma neto, d.m.th. shuma bruto pas zbritjes prej 20% për kostot e arkëtimit.



Bruksel, 8.11.2023
COM(2023) 692 final

SHTOJCË

SHTOJCË

për

**Propozimin për RREGULLORE TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË
KËSHILLIT**

për krijimin e Mekanizmit për Reformë dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor

SHTOJCA

Metodologjia për shpërndarjen e burimeve globale për përfitues

Shpërndarja e çdo Përfituesi do të llogaritet në përputhje me hapat e mëposhtëm bazuar në të dhënat e vitit referues:

Hapi 1: përcaktimi i një çelësi të shpërndarjes së popullsisë bazuar në raportin e popullsisë së Përfituesit ndaj shumës totale të popullsisë për rajonin e Ballkanit Perëndimor;

Hapi 2: përcaktimi i një çelësi të shpërndarjes së BPV-së bazuar në raportin e BPV-së mesatare për kokë banori për rajonin e Ballkanit Perëndimor ndaj BPV-së për kokë banori të Përfituesit përkatës dhe pjesëtuar me shumën e gjashtë raporteve;

Hapi 3: kombinimi i peshave në përqindje të secilit vend për popullsinë sipas Hapit 1 dhe BPV-së për kokë banori sipas Hapit 2 me një faktor peshimi prej 60% të popullsisë dhe 40% të BPV-së për kokë banori.